



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 QERSHOR DHE 4 KORRIK 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. JUNA I 4 JULA 2013. GODINE**

**QERSHOR/KORRIK - JUN/JUL
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje,
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012,
7. Njoftim për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar ‘ZB’ për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji prvog međunarodnog sporazuma načela koji uređuju normalizaciju odnosa između Republike Kosova i Republike Srbije i plan implementacije ovog sporazuma,
5. Razmatranje izveštaja Komisije za unutrašnje poslove, sigurnost i nadgledanje KBS za nadgledanje sprovođenja Zakona o Policijskom inspektoratu Kosova,
6. Razmatranje Izveštaja o radu centralne izborne komisije za 2012. godine.,
7. Informisanje o predlogu Parlamentarne grupe SLS i Parlamentarne grupe ‘ZB’ o zamenjivanju članova u parlamentarnim komisijima Skupštine.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime është e kufizuar në 30 minuta. Në emër të grupit parlamentar është 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Shqetësimin që do ta trajtoj e kam përmbledhur në këtë definim: aspirimi për rend e perspektivë dhe orkestrimi për kaos e prapakthim.

Prej se ekziston Kosova, asnjëherë nuk ka qenë vend i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht sikur është sot. Prej që ekziston Prishtina si vendbanim, asnjëherë nuk ka pasur prani të tillë ndërkombëtare, politike dhe ushtarake për mbështetje të integritetit të plotë të Kosovës, sikur sot. Asnjëherë sikur se sot, Kosova nuk ka pasur trajtim ndërkombëtar dhe mbështetje politike e mbrojtje ushtarake çfarë ka sot. Prej që ekziston Kosova, asnjëherë sikur sot nuk e ka pasur këtë nivel të vetin emancipues në përfaqësimin e saj institucional dhe me kaq integritet. Prej se ekziston Kosova, asnjëherë që nga viti 1999 e deri sot nuk ka gëzuar mbështetje kaq konsekuente haptas.

Kështu, edhe adhurimi ynë për këto mbështetje do të jetë i përhershëm. Pavarësisht a ka ndonjë zë mosmirënjohjeje në mesin tonë, NATO-ja e ka numrin e ushtarëve besnikë me miliona nga hapësirat tona, kurdo që do t'i duhen, gjithnjë në rritje, deri sa ta kemi këtë natalitet. Beogradi nuk ka mundur ta ndalë përkrahjen ndërkombëtare që e gëzon Kosova; as ushtarakisht, as politikisht, as diplomatikisht. As vetë dhe as me mbështetjen e Rosisë.

Kjo gjendje është brengosëse për Beogradin. Këtë brengë do të mundohet ta zbusë me anë të strategjisë, që tani më sa kohë ka gjetur zbatues në Prishtinë. Asnjë shërbim më të mirë për Beogradin nuk mund ta bëjmë, se sa të konfrontohemi, me ata që na kanë përkrahur deri sot. Në këtë konfrontim, për të mos u hetuar veprimet në interes të Beogradit, atje është ndërtuar diskursi politik i katapultuar në Prishtinë dhe i justifikuar me motive nacionale, fetare dhe sociale, që do të zbatohet në faza të caktuara, duke ia përshtatur zhvillimeve politike. Dizajnimi është bërë në perfeksion, duke përshtatur pretekste në çdo zhvillim negociues në agjendën e institucioneve vendore dhe

ndërkombëtare, e cila e zhdruk praninë e Serbisë përfundimisht nga Kosova. Pretekstet janë hartuar gjatë shtrirjes së autoritetit kushtetues dhe të ruajtjes së integritetit territorial të Kosovës. Shikuar përciptazi dhe pa kompetencë, me pakëz shtytje nga postulatet tona të adhuruara kuqezi, të ngjallin veprime impulsive, deri në bindjen se sot interesat nacionale nuk mbrohen nga institucionet tona zyrtare, e konstruktuar vetëm për të krijuar kaos dhe anarki.

Veprime këto më të dëmshme për këtë vend dhe në këtë kohë, kur institucionet udhëhiqen dhe këshillohen nga një armatë e njerëzve të verifikuar me përkushtimin e tyre jetësor dhe me besueshmëri të legjitimuar, në konsulencë të përhershme me miqtë e dëshmuar. Sa herë që forcohet integriteti dhe sovraniteti i Kosovës, përpjekjet për kaos e anarki do të rriten, sipas strategjisë së tyre.

Faleminderit prej Zotit që është në anën tonë, me gjithë mrekullitë e fuqisë së tij së bashku me ne do të bëjë që të dështojnë të gjitha strategjitë që janë hartuar kundër vendit tonë! Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Ajo që pavarësisht zhvillimeve dhe atë që e shohim gjatë ditës së sotme, besoj që është me rëndësi për ta ngritur gjatë tërë kohës, ka të bëjë me nivelin e qeverisjes, ka të bëjë me problemet dhe vështirësitë që institucionet e Kosovës, sidomos institucionet që janë të rëndësishme për Kosovën, po ballafaqohen për shkak të nivelit të keq-qeverisjes.

Më lejoni që edhe sot ta ngre zërin në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për atë që kemi parë gjatë këtyre dy ditëve të fundit dhe kjo ka të bëjë me helmimin e kadetëve të Policisë së Kosovës. Ajo që vërtet është shqetësuese, është fakti se Policia e Kosovës, si institucion i zbatimit të ligjit, si njëri prej institucioneve më të besueshme në Kosovë, ka vështirësi dhe ballafaqohet vërtet me vështirësi dhe sfida të aspektit të sigurisë, por nuk besoj se do të duhet që policët e Kosovës, ata që trajnohen, kadetë për policë të Kosovës, të ballafaqohen edhe me çështjen e ushqimit dhe të helmohen në mensën e Akademisë Policore të Kosovës.

Kjo besoj se është për përgjegjësi. Këtu duhet të jepet përgjegjësi dhe realisht ky nivel i keq i qeverisjes dhe vazhdimi i skandaleve në Ministrinë e Brendshme, që e shohim ka vazhduar edhe nëpër agjencitë ose mekanizmat që janë brenda Ministrisë së Brendshme dhe në këtë rast Akademië Policore të Kosovës.

Prandaj, e ftojme Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme që menjëherë t'i nxjerrë para përgjegjësisë drejtuesit dhe njerëzit përgjegjës, personat përgjegjës për helmimin e kadetëve të Policisë së Kosovës.

Besoj se ky është shembulli më i keq që ne si politikë dhe Qeveria u jep policëve të Kosovës në mbrojtjen e tyre. Nuk ka mbrojtje derisa edhe kadetët helmohen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, të nderuar ministra,

Sot do të ngre një shqetësim në lidhje me moszbatimin, apo më mirë të them mosrespektimin e Ligjit numër 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre.

Kuvendi i Kosovës, më 8 dhjetor e ka miratuar Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre dhe prej miratimit të tij e deri më sot kemi një zbatim të pjesshëm, jo zbatim të plotë dhe respektim të plotë të këtij ligji.

Sipas nenit 6 të Ligjit për statusin e të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe viktimave civile dhe familjarëve të tyre, ky ligj u siguron rehabilitim mjekësor, fizikal për të gjithë invalidët, shërbime shëndetësore falas jashtë vendit, riaftësim profesional, kompensim ortopedik dhe përparësi në punësim, si dhe lirin nga tatimi e doganat për vetura për përdorim individual për invalidët e luftës dhe deri më tani Doganat e Kosovës kanë bërë një keqinterpretim të këtij neni dhe këtij ligji dhe nuk e ka zbatuar në përgjithësi.

Të nderuar deputetë,

Familje të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së,

Me gjithë përparësitë që u jep ligji në punësim, në kushte të barabarta, ata refuzohen nga individë të caktuar nëpër institucionet publike dhe private. Dua të besoj se ky moszbatim i ligjit nga individë të caktuar vjen si pasojë e mosnjohjes së ligjit dhe për statusin e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, sepse raste të moszbatimit të këtij ligji, sipas nenit 21 janë të sanksionuara me këtë ligj dhe janë të parapara gjobat prej 500 deri në 5 000 euro.

Me gjithë atë se ligji është miratuar në Kuvend më 8 dhjetor, është shqetësues moszbatimi dhe mosrespektimi i tij nga institucionet publike, në veçanti nga Ministria e Shëndetësisë, prandaj kemi numër e madh të invalidëve të luftës, të cilët detyrohen që për shërim, për sëmundjet e tyre jashtë vendit, ato t'i kompensojnë nga buxheti i tyre familjar. Gjithsesi, është shqetësuese edhe mospërgatitja e aftësimit profesional nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe mosrespektimi e zbatimi i ligjit nga Doganat e Kosovës.

Andaj, kërkoj nga të gjitha familjet e dëshmorëve, invalidët dhe të gjithë personat përgjegjës, nga ministrinë përkatëse ta zbatojnë Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

viktimave civile dhe familjarëve të tyre dhe në raste kur kemi moszbatim të tij, i ftoj të gjithë anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidët dhe viktimat civile të luftës që të bëjnë ankesa në institucionet përgjegjëse dhe moszbatuesit e këtij ligji të sanksionohen sipas ligjit në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk e kisha asnjë temë të veçantë ta ngrija sot në këtë pikë të rendit të ditës.

I nderuar kryetar,

Kryesues,

Zoti kryeministër,

Deputetë,

Sot po e marr fjalën, që të ju tregoj se unë pata telashe të hyj në Kuvendin e Kosovës.

Kam informata se edhe shumë kolegë tanë deputetë kanë vështirësi në këto momente që të hyjnë në ndërtesë, në sallën e Kuvendit të Kosovës.

Kërkoj zoti kryetar që t'u bëni thirrje kolegëve tanë deputetë, që është dashur të jenë këtu sot, të mos rrinë atje jashtë dhe t'i pengojnë kolegët e tyre të hyjnë në Kuvend.

Sot ka pasur dhunë fizike ndaj nesh. Sot fizikisht jemi penguar të hyjmë në vendin ku qytetarët na kanë dhënë mandatin të vijmë e të shtrojmë, të bisedojmë, të ngremë çështje për të cilat ka nevojë vendi ynë, për të cilat ka bërë agjendë Kuvendi i Kosovës.

Dëshiroj nga këtu t'i siguroj të gjithë ata qytetarë që më kanë votuar mua, që unë do ta kryej me nder detyrën time këtu në Kuvend. Dëshiroj ta siguroj familjen time dhe qytetarët që nuk lejojnë asnjëherë dinjitetin im të nëpërkëmbet dhe do ta kryej detyrën time ashtu si ata ma kanë besuar mua.

Këto ditë unë kam pasur shumë takime me votues, me qytetarë. I kemi biseduar edhe çështjet të cilat ne do t'i ngremë sot në rend dite dhe ju siguroj që jam dakord në frymën në të cilën janë edhe qytetarët e Kosovës, të gjithë ata që na kanë votuar dhe ata që nuk kanë dalë fare në zgjedhje.

Zoti kryetar, kërkoj që të bëni diçka e të mos pengohen deputetët sot të vijnë në sallën e Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Nuk kemi deputetë tjerë të paraqitur. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, për shkak se nuk kemi kuorumin që të vazhdojmë me pikat tjera.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Danush Ademi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri nuk është këtu. Deputet, doni ta parashtroni pyetjen? Urdhëro!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse nuk është ministri këtu, meqenëse janë kryeministri dhe zëvendëskryeministri, desha ta shtroj pyetjen, sepse është një shqetësim i madh për komunitetin tonë ashkali, që unë e përfaqësoj këtu.

Duke ditur se shumica e ashkalinjve janë në kategorinë e dytë, që e gëzojnë ndihmën sociale dhe pas ndryshimit të këtij ligji, neni 4, pika 4.5, e dëmton rëndë gjendjen e familjeve të ashkalinjve që gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale dhe rrezikon të largohen nga ndihma sociale për shkak se familjet tona bashkëjetojnë me pjesëtarët e familjeve, si prindër, vëllezër e tjera.

Pyetja ka të bëjë: Sa ka mundësi të punohet me një rekomandim shtesë dhe të sillet për votim në Kuvend, duke i respektuar të gjitha procedurat ligjore, që të përmirësohet ky nen dhe të rikthehet sikur ka qenë në gjendjen e mëparshme.

Kjo është një pyetje që ia kam parashtruar edhe më herët ministrit, por ende nuk kemi përgjigje.

Shumë familje rrezikohen t'u ndalet ndihma sociale, sepse neni i cili është ndryshuar tash i dëmton shumë familje, të cilat janë duke e gëzuar këtë të drejtë sociale.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Agim Kuleta, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Deputeti s'është këtu. Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Deputetja s'është këtu. Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen?

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ngaqë e kam një shqetësim aktual dhe mjaft brengosës për mua, për deputetët tjerë të zonës së Malishevës dhe për qytetarët e Malishevës, si dhe për qytetarët e komunave përreth Malishevës, por edhe për deputetët tjerë të Grupit Parlamentar që e kemi diskutuar këtu bashkë, po e shpreh një shqetësim, të cilin ministri i Shëndetësisë duhet ta marrë edhe një herë shumë më seriozisht se sa herëve tjera, kur e kam trajtuar këtu në këtë Kuvend, para se të fillojnë ethet hemorragjike.

Ne, në këtë deçenie nga ethet hemorragjike kemi 33 të vdekur, qytetarë të vendit tonë. Vetëm këtë muaj kanë vdekur 5 qytetarë, e në rrezik jete janë edhe shumë të tjerë. Pasiguria dhe ankthi i qytetarëve të zonës së rrezikuar të komunave me epiqendër Malishevën është e papërshkrueshme. Hija e vdekjes është shoqëruese në përditshmërinë e kësaj zone.

Unë nga këtu e pyes ministrin, i cili ndoshta na dëgjon, ose stafi i tij i bashkëpunëtorëve: Masat që janë ndërmarrë deri më tani nga institucionet e shtetit nuk janë të mjaftueshme - a duhet të bëni programe të tjera në Ministrinë e Shëndetësisë për t'i parandaluar vdekjet nga ethet hemorragjike?

Kjo do të duhej të ishte pyetja ime drejtuar atij dhe do të duhej të motivohej për t'i dhënë përgjigje, jo deputetit të zonës, por qytetarëve të rrezikuar të Malishevës dhe të komunave përreth. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Krasniqi, e ke edhe pyetjen tjetër drejtuar ministrit Besim Beqaj.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Edhe preokupimi tjetër që e kam shtruar dhe pyetjen që ia kam bërë ministrit Beqaj, është e motivuar nga të njëjtat shqetësime. Gjithashtu humbja e 33 qytetarëve pas luftës nga ethet hemorragjike, vdekja e 5 qytetarëve nga ethet hemorragjike këtë muaj, natyrisht që kanë krijuar shqetësim të gjithanshëm dhe këtë shqetësim ka qenë e pamundur të mos e përsëris për të satën herë në këtë Kuvend, por kësaj radhe i jam drejtuar edhe ministrit të Financave, duke e formuluar kërkesën dhe pyetjen për dikasterin e tij, sepse kemi nevojë tani edhe për ministrin e Financave.

Zoti ministër, masat që janë ndërmarrë deri më tani nga institucionet e shtetit nuk janë të mjaftueshme. A keni menduar për të ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ndonjë shumë financiare për ndonjë program që e preferojnë ekspertët për t'i parandaluar vdekjet nga ethet hemorragjike?

Një ide. Unë në konsultim me ekspertë kam ardhur në konkluzion se duhet t'i bëhet një ofertë një instituti prestigjioz, i cili do të duhej të vinte të merrte mostra e të bënte analiza, por për këtë duhen fonde dhe ju më mirë e dini se si dhe qysh i bëni këto. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Deputet Krasniqi,

Sigurisht se është një çështje jashtëzakonisht serioze dhe Qeveria është duke e përcjellë nga afër gjendjen e krijuar, duke i harmonizuar të gjitha veprimet tona në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Ju e dini që Ministria e Financave e menaxhon buxhetin në bazë të kërkesave buxhetore dhe ndarjeve buxhetore, të cilat janë të parapara dhe prioritetizimi i mjeteve buxhetore bëhet nga ministritë sipas prioriteteve, të cilat ata i kanë.

Megjithatë, në këtë drejtim, Ministria e Financave, më 31.5.2013 e ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për transferin e mjeteve nga nën-programi i Agjencisë për Përkujdesje Shëndetësore në Institutin e Shëndetit Publik, në shumën prej 156 000 eurove dhe kjo është bërë gjithmonë për parandalimin e etheve hemorragjike.

Në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2013, Ministria e Financave e ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për blerjen e automjetit, i cili do të shërbejë për

bartjen e ekipeve profesionale dhe pajisjeve të ndryshme nëpërmjet të cilave do të bëhet pastrimi i terrenit nga rriqrat.

Si do që të jetë, dua të ju them juve dhe qytetarëve edhe të asaj ane, por edhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës se kur është në pyetje shëndeti publik i qytetarëve të Republikës së Kosovës, ne do t'i gjejmë të gjitha mundësitë që t'u ndalim në ndihmë dhe t'i përkrahim ata për ta tejkaluar këtë gjendje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Krasniqi, keni pyetje shtesë?

HALIT KRASNIQI: Pyetje shtesë nuk do të parashtroj, por një konkluzion do ta nxirrja nga kjo deklaratë.

Me këtë premtim, edhe unë, edhe qytetarët e zonës do të jenë më të inkurajuar, por ju kisha lutur që të mos mbeten vetëm deklarata dhe vetëm premtime sikur se është një mendim në të kaluarën, që ka ndodhur kështu.

Unë kam besim në deklaratën tuaj dhe në përkushtimin e Ministrisë suaj dhe të Qeverisë, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetja e gjashtë është e deputetes Albulena Gashi. Albulena s'është këtu. Pyetja e shtatë është e deputetes Albulena Haxhiu. Nuk është këtu. Pyetja e tetë, deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për kryeministrin. Edhe kjo deputete s'është këtu. Pyetja e nëntë, është po nga e njëjta deputete, që nuk është këtu. Dhe, kështu e kemi përfunduar edhe pikën e dytë të rendit të ditës. Për çka e do fjalën? Po, vetëm mund të ngjallë debat. Për deklarime jashtë rendit të ditës, fjalën e ka ministri Hoxhaj.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Zoti nënkryetar,

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,
Shumë të nderuar deputetë,

Dita e sotme do të jetë një ditë shumë e veçantë për historinë e Kosovës, meqë do ta ratifikojmë përfundimisht marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Unë dola në këtë foltore, jo të flas për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, por ta ngre një shqetësim, edhe si njeri në politikë, por edhe si qytetar i Republikës së Kosovës, një shqetësim i cili i referohet një situatë para disa minutash.

Deputeti Blerim Shala, deputetja Time Kadrijaj dhe Sala Berisha dhe unë si ministër i Jashtëm ishim duke hyrë në ndërtesën e Kuvendit, përderisa nga deputetët e Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe nga një turmë e njerëzve ishim para një sulmi fizik.

Unë e kuptoj që nëse një vend synon ta ndërtojë demokracinë që të ketë ballafaqim të ideove, që të ketë pikëpamje të ndryshme, mirëpo nëse dhuna është qëllim politik i fundit i një grupi politik dhe nëse sulmi fizik është mjet politik për ta arritur një qëllim të tillë,

unë mendoj që kjo lëvizje politike dhe Kuvendi i Kosovës duhet të distancohet nga zhvillimet e tilla.

Prandaj, kërkoj nga kryetari i Kuvendit që t'i marrë të gjitha masat që çdo deputet dhe çdo ministër që është i interesuar të hyjë në seancë, të krijohen parakushte që këta njerëz të hyjnë në seancë.

Po ashtu, kërkoj nga Policia e Kosovës që të jetë shumë më e përgjegjshme dhe ne mos të kemi situata të para njëzet vjetëve, kur realisht sulmohemi nga një lob politik, nga një turmë politike, e cila qëllimin e fundit e ka dhunën fizike.

Zoti kryetar,

Mendoj se është në duart e këtij institucioni që të krijojë parakushte që çdokush që do të hyjë në këtë Kuvend të demokracisë ta ketë të drejtën të hyjë dhe çdo ministër, i cili duhet të japë llogari para këtij Kuvendi, po ashtu të vijë në këtë Kuvend.

Situata të tilla janë të papranueshme dhe unë mendoj që kryetari i Kuvendit ka përgjegjësi që të krijojë kushte të tilla që ne të hyjmë brenda, dhe ministri i Brendshëm, i cili s'është këtu, po ashtu, duhet të krijojë kushte që çdokush që synon të hyjë në sallë, të sillet në sallë dhe të mos kemi situata, të cilat nuk i përngjajnë një vendi që synon të integrohet në Bashkim Evropian.

KRYETARI: Ministër, kryetari e ka përgjegjësinë në Kuvendin e Kosovës. Nuk është as polic, as kryexhandar, as prokuror, as gjykatës. Detyrat janë të përcaktuara dhe dihen.

Ne përgjigjemi dhe kemi obligim për të garantuar zhvillim normal të seancës dhe punës brenda hapësirës së Kuvendit. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dua të komentoj fare, se s'ka nevojë për asnjë koment për situatën e krijuar dhe çka është kah ndodh këtu. Është fyerje, jo vetëm për deputetët e Kuvendit të Kosovës, por edhe për të gjitha institucionet e vendit. Janë fyer edhe miqtë tanë më të mirë, janë penguar për të marrë pjesë në këtë seancë, e them hapur, të një rëndësie të veçantë, por megjithatë duke i pasur parasysh rrethanat, unë propozoj apo kërkoj një pauzë prej 30 minutash, derisa të krijohen kushtet normale për të vazhduar më tutje. Por, kërkoj që brenda sallës së Parlamentit vërtet të udhëhiqet ashtu si duhet dhe të krijohen kushte normale për vazhdim të seancës. Faleminderit!

KRYETARI: Ne edhe ashtu nuk e kemi kuorumin për të vazhduar me pikat tjera të rendit të ditës. Brenda seancës dhe brenda Kuvendit, ju po shihni se gjithçka është kah shkon në rregull, përveç mungesës së deputetëve. Për deputetët dhe për administratën, orari i punës është prej orës 8:00 të mëngjesit. Grupet parlamentare është dashur të jenë me deputetë prej orës 9:00. Është dashur pak ta parashohin këtë edhe organet tjera, por edhe deputetët.

Përndryshe, ne për këtë pjesë të Kuvendit jemi mirë. Çdo gjë është e rregullt, çka ndodh jashtë oborrit të Kuvendit, përgjegjësia është e institucioneve përkatëse, kështu që të mos i ngatërrojmë gjërat.

Pasi nuk kemi kuorum për ta vazhduar seancën, e bëjmë një pauzë prej 30 minutash dhe në ndërkohë, nëse vijnë deputetët, vazhdojmë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 20 qershor 2013

Të pranishëm janë 64 deputetë. Pyes nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nëse nuk keni, atëherë konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 20 qershor 2013.

Për pikën e katërt të rendit të ditës, mund të fillojmë debatin, por s'mund të marrim vendim, me këtë prani të deputetëve.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje

Të pranishëm janë 74 deputetë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar ambasadorë,

Të gjithë ju mysafirë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni të paraqes për miratim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare që rregullon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së

Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të parafuar më 19 prill 2013 nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës së Serbisë.

Në fillim më lejoni të prezantoj zhvillimet të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes si dhe rezultatet që procesi i deritanishëm i bisedimeve i ka vënë në fushën e realizmit të synimeve dhe objektivave tona.

Arritja e Marrëveshjes ndërlidhet me qëllimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të respektohet në tërësi obligimi kushtetues për zbatimin e pikës 5 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës e të Serbisë, të aprovuar nga një shumicë e madhe demokratike e Kuvendit të Kosovës, në tetor 2012.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj se kanë kaluar 14 vjet që kur qytetarët e Kosovës jetojnë në liri dhe mbi 5 vjet nga koha kur në mënyrë të koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare e shpallëm Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Jemi dëshmitarë se të gjitha dilemat dhe kundërshtimet rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë u rrëzuan kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dha verdiktin në të cilin theksohet dhe argumentohet se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Pavarësia e shtetit tonë dhe liria për qytetarët e Kosovës është e sigurt përgjithmonë.

Rrjedhja e ngjarjeve në rajon gjatë viteve të fundit, ka provuar se pavarësia e Republikës së Kosovës dhe njohja ndërkombëtare e saj ka dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë për sigurimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit, Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Dje, Kosova zyrtarisht u njoh nga Egjipti, duke shënuar njohjen formale të 100-të për Kosovën.

Ky moment dëshmon se Kosova pandalshëm është duke e zënë vendin e saj të merituar në mesin e kombeve të lira të botës.

Kemi qenë dhe jemi të vetëdijshëm se arritja e synimit për paqe dhe siguri në Ballkan do të jetë e pasigurt pa njohjen e shtetit të Kosovës nga të gjitha vendet fqinja, përfshirë edhe Serbinë.

Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet shteteve fqinja në rajonin tonë është parakusht për stabilitet, për sundim të ligjit, për zhvillim ekonomik dhe për zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin në Bashkim Evropian dhe në NATO.

Procesi i fillimit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e ka bazën kryesore të bindja e të gjithë aktorëve ndërkombëtarë se rruga e pavarësisë është e

pakthyeshme, ndërsa procesi i normalizimit të raporteve ndërmjet dy shteteve të pavarura është i pashmangshëm.

Një bindje e tillë, pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare, u reflektua edhe nga strukturat e tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në veçanti, shprehje e kësaj bindje ishte Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e datës 9 shtator 2010, e cila e fton, si Kosovën, ashtu edhe Serbinë, që si dy shtete të pavarura ta fillojnë punën për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella nëpërmjet një dialogu teknik.

Rezoluta, ndër të tjera, i prezantoi edhe synimet e dialogut për vendosjen e paqes, sigurisë dhe stabilitet në rajon, si dhe nevojën që nëpërmjet këtij dialogu të bëhet promovimi i mëtejshëm i bashkëpunimit, arritja e progresit në procesin e integriteteve evropiane dhe përmirësimin e jetës së njerëzve.

Synimet e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme, si dhe të proceseve që ka pasuar pastaj, janë plotësisht në pajtim me synimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Ne të gjithë, por besoj se edhe qytetarët e Kosovës, e kanë ditur që nga fillimi se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të jetë fare i lehtë.

Përkundrazi, të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm se procesi do të jetë i vështirë, i komplikuar dhe që do të marrë kohë.

Fazën fillestare për normalizim e filluam me dialogun teknik për zgjidhjen e një sërë çështjesh.

Rezultatet që dha dialogu teknik kanë rrëzuar parashikimet e shumë skeptikëve dhe kundërshtarëve më të mëdhenj të këtij dialogu.

Dialogu teknik rezultoi me një numër të marrëveshjeve të arritura, të cilat në masë të madhe kontribuojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike, fetare apo politike, siç edhe e përcakton Kushtetuta jonë.

Si rezultat i marrëveshjeve në nivelin teknik, Kosova përfaqësohet në forumet rajonale dhe më gjerë,

I kemi vendosur kufijtë shtetërorë në të gjitha pikat kufitare, ndërsa kalimi kufitar është lehtësuar për të gjithë qytetarët që i frekuentojnë pikat tona kufitare.

Është mundur që Kosova të vendosë kontroll në të gjitha pikat kufitare dhe e kemi aplikuar sistemin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Policëve tanë dhe doganierëve të Republikës së Kosovës u është bërë e mundur dhënia e

kontributit të tyre në plotësimin e parakushteve për integritet euroatlantike, e po ashtu edhe vendosja e rendit dhe ligjit në disa pika problematike kufitare.

Jemi duke e realizuar kthimin e regjistrave civilë për qytetarët e Republikës së Kosovës, kemi njohjen e diplomave të institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës nga Serbia dhe çështje tjera.

Përveç përfitimeve direkt nga qytetarët tanë, dialogu teknik provoi se Serbia filloi ta njohë realitetin e krijuar në Kosovë me shpalljen e shtetit të Kosovës dhe njohjen e saj nga më shumë se gjysma e shteteve të botës.

Si rezultat i dialogut, u forcua dhe u avancua edhe më tutje subjektiviteti ndërkombëtar i shtetësisë së Kosovës dhe avancimi i shtetit.

Tashmë kemi arritjen e numrit treshifror (100) në njohjet e shtetit të Kosovës, kemi anëtarësimin në institucione ndërkombëtare dhe rajonale, të cilat në gjirin e tyre pranojnë vetëm shtetet, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kemi anëtarësimin në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, kemi vendimin për pranim në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, njohjet e reja dhe anëtarësimet në organizata rajonale dhe ndërkombëtare pritet të bëhen në vazhdimësi.

Mbi të gjitha, si rrjedhojë e punës sonë serioze në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe si rezultat i përmbushjes së standardeve evropiane, Kosova tashmë e ka marrë dritën jeshile për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për Kosovën, ku trajtohet si shtet, si të gjitha shtetet tjera.

Edhe pse pesë vende të Bashkimit Evropian që ende nuk e kanë njohur Kosovën, sot të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian e mbështetnin të ardhmen konkrete evropiane të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Shtrirja e sundimit të ligjit dhe zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në tërë territorin e saj ka qenë, është dhe do të mbetet prioriteti dhe interesi kryesor i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i të gjitha institucioneve tona.

Ngritja e dialogut në nivel politik ndërmjet kryeministrave të të dyja vendeve të pavarura dhe të barabarta ka rezultuar me hapa konkretë në drejtim të arritjes së këtij qëllimi, ndërsa rezultatet janë të dukshme.

Pas njëmbëdhjetë rundeve të dialogut politik, më 19 prill 2013 u arrit marrëveshja e parë historike ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, Baroneshës Eshton dhe mbështetjen e fuqishme të SHBA-ve.

Marrëveshja, të cilën sipas rregullave për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare po e paraqesim sot për ratifikim para jush, përmban 15 pika, të cilat i rregullojnë aspektet thelbësore për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Marrëveshja hap rrugën për vendosjen e stabilitetit në veri të Kosovës nëpërmjet transformimit rrënjësor të gjendjes aktuale të sigurisë, si dhe të kushteve politike dhe ekonomike.

Marrëveshja hap perspektivën e Kosovës për ta përmbyllur procesin e njohjeve ndërkombëtare dhe anëtarësimin e Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe OKB-në.

Marrëveshja siguron dhe plani i implementimit vendos detajet që deri në mes të muajit korrik 2013, Serbia do t'i mbyllë të gjitha strukturat e saj të sigurisë në Kosovë dhe të përfundojë ofrimin e përkrahjes financiare.

Tashmë e dimë se Qeveria e Serbisë ka marrë vendim për ndalimin e financimit të atyre strukturave ilegale të sigurisë dhe tashmë janë mbyllur disa stacione policore të MUP-it, të cilat në mënyrë të paligjshme kanë operuar në veri të vendit.

Marrëveshja siguron që Policia e Kosovës do të jetë i vetmi autoritet legal dhe legjitim policor në veri të Kosovës.

Një komandat rajonal i Policisë është emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, e gjitha kjo sipas marrëveshjes.

Me këtë pikë, përfundimisht, sundimi i ligjit do të forcohet në veri të Kosovës, si dhe autoritetet për zbatimin e ligjit do të bashkëpunojnë në mënyrë edhe më efektive.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Marrëveshja konfirmon sistemin unitar ligjor të Republikës së Kosovës si të vetmin autoritet ligjor në vend.

Integrimi me kohë i autoriteteve gjyqësore brenda sistemit ligjor dhe të drejtësisë së Kosovës është esencial dhe ne konsiderojmë se ky kompozim i sistemit gjyqësor do ta rrisë besimin e komuniteteve në gjykatat e Kosovës, do të përmirësojë marrëdhëniet ndëretnike, dhe mbi të gjitha do të vendosë sundimin e ligjit në veri të vendit që ka munguar në 14 vjetët e fundit.

Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, ne për herë të parë pas 14 vjetëve, do të jemi në gjendje të organizojmë zgjedhjet komunale në veri të Kosovës në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën mënyrë, siç do të bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Unë përfitoj nga rasti që t'i falënderoj të gjithë liderët politikë të partive politike të

Kosovës, të cilët janë treguar shumë racionalë dhe i kanë dhënë mbështetje të plotë marrëveshjes që zgjedhjet lokale të mbahen më 3 nëntor.

Siç e dimë, disponimi i të gjithë neve ka qenë që zgjedhjet lokale të mbaheshin më herët.

Mirëpo, të gjithë ne e kemi vënë në rend të parë interesin shtetëror përpara atij partiak.

Të gjithë jemi pajtuar që interesi i shtetit, interesi i shoqërisë kosovare është normalizimi i gjendjes në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, integrimi i gjithë qytetarëve në shoqërinë kosovare, dhe mbi të gjitha organizimi i zgjedhjeve në gjithë vendin në të njëjtën ditë, me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve dhe të të gjitha komuniteteve.

Zgjedhjet do të mbahen në përputhje me ligjet e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, ndërsa institucionet përgjegjëse të Kosovës do t'i organizojnë ato.

Në të njëjtën kohë, ne si institucione të vendit i kemi bërë ftesë, gjithmonë duke u nisur nga përmbajtja e marrëveshjes së 19 prillit, OSBE-së për lehtësimin e organizimit dhe menaxhimit të zgjedhjeve në veri.

Një aspekt tjetër i marrëveshjes është formimi i një asociacioni, i cili do të funksionojë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Asociacioni do të jetë pjesë integrale e institucioneve të Kosovës dhe si i tillë do të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë qendrore gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij. Ekipi përgatitor për themelimin e asociacionit tashmë e ka filluar punën.

Me marrëveshje gjithashtu kemi pajtim të ndërsjellë se asnjëra palë nuk do të bllokojë, e as t'i inkurajojë të tjerët ta bllokojnë përparimin e njëri-tjetrit në rrugën drejt integritetit në Bashkim Evropian.

Ky sigurim i ndërsjellë është një aspekt tjetër që dëshmon se rruga e integritetit evropian për të dyja vendet do të jetë e sigurt dhe e shpejtë, bazuar në kushtet dhe meritat individuale.

Prandaj, ju garantoj se gjithçka është e aranzhuar në atë mënyrë që të respektohet në plotësi Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës.

Ne jemi të vetëdijshëm se duhet të bëhet edhe më tepër dhe do të bëjmë. Por, jemi dëshmitarë se marrëveshja ka filluar të implementohet edhe në terren dhe po jep rezultatet e veta.

Të nderuar deputetë

Në fund, i falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për mbështetjen e tyre, për besimin e tyre. I falënderoj liderët politikë kosovarë, që secili prej tyre ka vënë

interesat e shtetit dhe të qytetarëve mbi disponimet e agjendave tona partiake apo elektorale.

Mendoj se marrëveshja i ka hapur një rrugë të sigurt evropiane Kosovës dhe rajonit, në përgjithësi.

Ndërsa, tani Kosova edhe konkretisht është futur në binarët e integriteteve evropiane dhe ky proces është i pandalshëm.

Për të gjitha këto arsye dhe shumë tjera që nuk i përmenda në këtë adresim timin, unë ju ftoj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ju edhe një herë të votoni për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, që është marrëveshja e parë ndërshtetërore dhe ndërkombëtare për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Edhe një herë, si kryeministër i Republikës së Kosovës, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të nderuar deputetë, të të gjitha partive politike që jeni, ju falënderoj për besimin tuaj, për mbështetjen tuaj, për sugjerimet tuaja, natyrisht ndonjëherë edhe për kritikën tuaj.

Por, të gjithë e kemi pasur një qëllim dhe një vizion, normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore të Kosovës me fqinjët, në kuadër të saj edhe normalizimin e marrëdhënieve me shtetin e Serbisë, dhe përshpejtimin e agjendës evropiane për Republikën e Kosovës.

Prandaj, edhe një herë ju ftoj që ta votoni për ratifikim këtë marrëveshje, që është marrëveshja e parë ndërshtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, Arben Gashi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe i rekomandon seancës tri amendamente. Këto amendamente kanë për qëllim heqjen e shtojcës B të projektligjit, sepse kjo shtojcë është në kundërshtim me vetë marrëveshjen, me parimet në bazë të marrëveshjes dhe është në kundërshtim me interesat e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në fillim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të shprehë indinjatën e thellë për kërcënimet e sigurisë fizike që iu bënë deputetëve të Kuvendit të

Kosovës, por edhe përfaqësuesve diplomatikë të shteteve mike të Kosovës para se të fillojë kjo seancë dhe që indinjata shkon e bëhet edhe më e thellë kur pjesë e këtij kërcënimi të sigurisë fizike bëhen edhe kolegët tanë deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Sa i përket marrëveshjes, më lejoni të ju them se nuk kemi nevojë të flasim shumë për dy arsye.

E para, është se është folur mjaft për marrëveshjen, është folur në këtë Kuvend, rregullisht është raportuar në Kuvend, është folur në media dhe qytetarët e kanë të qartë rëndësinë që ka kjo marrëveshje.

Fakti se qytetarët e kanë të qartë tregon edhe qetësia e tyre absolute që ata sot tregojnë në raport me përpjekjet tona që të ratifikohet kjo marrëveshje me qëllim që ne të ecim tutje.

Mendoj se në emër të Grupit Parlamentar, prej fillimit e kemi mbështetur këtë proces dhe do të vazhdojmë ta mbështetim, të bindur se ky proces siguron shtrirjen e sovranitetit tonë të plotë në gjithë territorin e Kosovës, se ky proces na jep mundësinë që të jemi më afër BE-së dhe se ky proces u jep mundësi edhe qytetarëve të asaj pjese të Kosovës që të bëhen pjesë e integruar e institucioneve tona dhe të funksionalizohet jeta atje.

Dëshiroj që në emër të Grupit Parlamentar t’i falënderoj të gjitha grupet parlamentare mbështetëse të këtij procesi dhe t’i inkurajojë që të vazhdojmë bashkërisht deri në fund të këtij procesi, të jemi bashkë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë ratifikimin, ashtu siç e ka votuar edhe miratimin dhe ju inkurajojmë edhe të tjerët që ta bëni këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Ne sot e marrim një vendim ndër më të rëndësishmit të kësaj legjislature.
Ne sot po vendosim për apo kundër marrëveshjes së parë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kjo marrëveshje është e shoqëruar me polemika të mëdha dhe me sfida të shumta. Janë dhënë mendime dhe vlerësime pro dhe kundër kësaj marrëveshjeje. Secila palë ka argumentuar dhe i ka argumentet e saj.

Një palë - “Vetëvendosje”, proteston jashtë Parlamentit.

Një palë, kryeministri mezi pret ratifikimin, duke fërkuar duart për një shpërblim personal.

Qytetarët janë të frikësuar për të ardhmen e tyre dhe të vendit të tyre.
Ne jemi sot në një moment vendimmarrjeje të rëndësishme për vendin.

Ne sot duhet ta kemi një përgjegjësi të jashtëzakonshme në vendimmarrje.

Dilema ndërmjet votimit për dhe votimit kundër është shumë e madhe.

Në qoftë se ne votojmë kundër, ashtu siç na thotë zemra, çfarë do të përfitojë Kosova, dhe në qoftë se ne votojmë për, ashtu siç na thotë mendja dhe bashkësia ndërkombëtare çfarë do të humbasim?

Unë mendoj se vota kundër sjell një rrezik të paparashikueshëm. Do të na vendoste për herë të parë në këto 25 vjet të fundit të luftës sonë për pavarësi në anën e kundërt me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, me përkrahësit e pavarësisë së Kosovës dhe të sovranitetit tonë.

Kosova si shtet i pazhvilluar ende, me këtë elitë të korruptuar politike, në qoftë se mund t'i themi elitë, nuk mund të qëndrojë në këmbë të veta pa mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian.

Ne e kemi marrë këtë mbështetje vazhdimisht dhe në vitin 1999 ajo kulmoi me çlirimin e Kosovës. Kjo elitë e papërgjegjshme, e korruptuar dhe kriminale e politike të Kosovës na ka sjellë sot aty ku jemi të detyruar që për ta ruajtur mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë ta modifikojmë rregullimin tonë të brendshëm territorial, duke krijuar asimetri të rrezikshme pushtetesh.

Pra, SHBA-të dhe BE-ja e kërkojnë pro votën tonë. Kjo është fatura e kësaj qeverisjeje dhe e kësaj elite, që në vend që të merret me konsolidimin e shtetit, u mor me konsolidimin e llogarive bankare dhe bizneseve personale.

Pra, kjo marrëveshje nuk është për meritën e kryeministrit Thaçi, por për fajin e tij.

Unë e di se shumica dërmuese e deputetëve të këtij Kuvendi, si dhe shumica dërmuese e popullit të Kosovës, përveç arsyeve madhore kombëtare, kanë edhe arsye personale, politike, familjare, të cilët refuzojnë çdo bashkëpunim me Serbinë, përderisa ajo të mos kërkojë falje, t'i paguajë dëmshpërblimet e luftës dhe ta tërheqë policinë dhe strukturat e saj të sigurisë nga tërë territori i Kosovës.

Por, ne sot po angazhohemi, siç jemi angazhuar dhe siç e kemi për detyrë kushtetuese, por edhe morale, familjare, politike, që në rrethana të cilat gjendet vendi ta bëjmë punën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Unë e di se shumica e deputetëve këtu mendojnë se Kuvendi, Qeveria dhe institucionet e Kosovës është dashur të bëjnë punë më të mirë. Ta përfaqësojnë Kosovën më denjësisht dhe unë ju jap plotësisht të drejtë dhe e kam të njëjtin mendim me ta.

Unë e di, siç e di secili qytetar i Kosovës, se kjo Qeveri është e paaftë ta drejtojë këtë proces.

Që nga dita kur kanë filluar bisedimet me Serbinë, LDK-ja ka ndërmarrë veprime të përgjegjshme, që është në sjelljen e lartësisë të detyrës dhe përgjegjësisë institucionale.

Ne e kemi paralajmëruar Qeverinë e Kosovës se çdo bisedim apo dialog me Serbinë është politik dhe është mediokritet të mendohet që është teknik.

Kryeministri Thaçi tha se kurrë nuk do të ketë bisedime politike me Serbinë, e sot po e ratifikojmë marrëveshjen e parë politike me Serbinë.

Për ta parandaluar rrezikun që i kanosej vendit nga sjelljet e papërgjegjshme të Qeverisë, ne morëm veprime konkrete dhe propozuam rezolutë në Kuvendin e Kosovës, që çdo marrëveshje me Serbinë të ratifikohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Ky ishte një veprim kontrolli institucional mbi veprimet e mundshme të papërgjegjshme të Qeverisë.

Pas kësaj pasuan veprime, të cilat dhanë po ashtu pasojat e tyre. Me kërkesë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, u thirr dhe u mbajt debat parlamentar për liritë dhe të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, kur pasoi edhe Rezoluta e Kuvendit, e cila e detyron Qeverinë e Kosovës që të angazhohet për të drejtat e shqiptarëve në Luginë dhe për promovimin e këtyre të drejtave.

Në vazhden e veprimeve politike për mbrojtjen e interesit të shtetit dhe të Kosovës, me këmbënguljen e LDK-së u arrit që plani i zbatimit, me qëllim të anashkalimit të Kuvendit, me vendimmarrje në Kuvend, në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë të shkëputet nga marrëveshja dhe të mos ratifikohet në Kuvend.

Po ashtu, ne mbetemi të angazhuar në shumë çështje tjera të rëndësishme për vendin dhe angazhohemi fuqimisht ta mbrojmë interesin e vendit, duke kërkuar dhe sugjeruar veprime konkrete, me qëllim të ruajtjes së interesit të vendit, veprime siç janë:

Këmbëngulja në ratifikimin e marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve dhe në Kuvendin e Serbisë, në mënyrë që palët të konsiderohen partnere në vendimmarrje dhe të kenë pasoja juridike të njëjta.

Angazhimi maksimal për mospranim të ndryshimeve ligjore dhe të mundshme në sistemin e Kosovës, që krijojnë baza etnike që të mos ketë elementë të rrezikimit të sistemit juridik të vendit.

Prandaj, ne sot vendosim për parimet dhe ratifikojmë parimet, por jemi këtu për ta mbrojtur interesin e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju deputetëve s’po ju drejtohem, meqenëse nuk e meritoni dhe nuk jeni të tillë. Kur qe miratuar Rezoluta në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës, që e nisi dialogun politik, atëherë ne e patëm quajtur atë rezolutë... ndaj Serbisë, dhe ja tash ku jemi në këtë pikë,

kur e keni nënshtruar secili prej jush qafën ndaj kërkesave të Serbisë edhe pushtetit të Serbisë në Kosovë.

E tash po shiteni thua se nuk po e dimë se çfarë po bën marrëveshja. Marrëveshja e dimë fort mirë se çka po na bënë. E dini fort mirë edhe ju të LDK-së, e dini edhe ju të PDK-së, edhe ju të AAK-së, që marrëveshja përfundimisht e etablon ndarjen e brendshme të Kosovës në baza etnike nëpërmjet krijimit të asociacionit, pra të këtij rajoni autonom përbrenda Kosovës, i cili do ta ketë, përveç pushtetit ekzekutiv, edhe buxhetin e vetë paralel në atë që po quhet fondi i zhvillimit.

Pra, kjo ndarje e Kosovës nuk është tash duke u fshehur nga askush. Është shumë e qartë. Pra, jemi në një situatë, që ju s'po koni ta kuptoni, jo që është vështirë ta kuptoni.

Çështja e dytë, kjo marrëveshje e amnistion pushtetin kriminal dhe ilegal të Serbisë në territorin e Kosovës. Nëpërmjet amnistimit, kjo edhe e legalizon atë dhe e formalizon praninë e tij në të.

Pra, në vend se strukturat paralele të shpërbëhen, në vend se atyre t'u ndërpritet financimi, çfarë po ndodh? Është që ato po ribëhen përbrenda strukturave të Policisë së Kosovës, të gjyqësisë së Kosovës, madje-madje edhe të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, dhe nga financimi nga Serbia po kalojnë në financim të Kosovës.

Pra, tash e tutje, Kosova me buxhetin që do t'ia ndajë detyrimisht asociacionit, do t'i financojë strukturat ilegale të Serbisë, këto struktura që kanë vrarë shqiptarë, që i kanë dëbuar shqiptarët prej pjesës veriore, që e kanë vrarë Selver Haradinajn, që e kanë vrarë Enver Zymberin, dhe që i kanë bërë të gjitha ato krime kundër shtetit, kundër pronës private dhe kundër njerëzve në veri.

E keni parë që tash Nenad Gjuriqi, i caktuar nga ministri i Rendit dhe i përshëndetur nga kryeministri i Kosovës si komandant rajonal i veriut, është në të vërtetë një kriminel ordiner, i cili ka qenë i përfshirë në kontrabandë bashkë me Veselinoviqin, kriminelin tjetër të veriut, dhe i cili po ashtu ka qenë pjesë e strukturave policore të Milosheviqit, bashkë me vëllanë e tij, që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në rrahjen dhe në maltretimin e shqiptarëve të Kosovës gjatë vitit 1998. Dhe, tash ky person, kryeministër, po të bëhet, ose e ke bërë komandat të Policisë së Kosovës, në emër të patriotizmit tënd.

Tjetra që po ndodh, marrëveshja e dezintegron Kosovën. Nuk e integron veriun. Është gabim të mendohet, madje-madje edhe turp se si po e thoni një gjë të tillë. Për shkak se me marrëveshjen po krijohet asociacioni autonom i komunave, i cili jo që nuk po i integron komunat e veriut përbrenda Kosovës, por po i çintegron edhe ato komuna në jug të Kosovës, të cilat deri tash kanë qenë të konsideruara si disa komuna me shumicë serbe, e që u janë përshtatur ligjeve edhe institucioneve të Kosovës.

Pra, asociacioni nuk është vetëm për katër komunat në veri. Asociacioni është për secilin vendbanim me shumicë serbe, që do të anëtarësohet në këtë asociacion dhe në këtë mënyrë do të zgjerohet pushteti i Serbisë edhe nëpër pjesët tjera të territorit të Kosovës.

Dhe, për më tepër, asociacioni në këtë marrëveshje dhe me ligjet që do të pasojnë, që do të ndryshohen pas kësaj marrëveshjeje, është në fakt edhe më i fuqishëm se vetë Kosova, për shkak se asociacioni, me përfaqësimin e vet që do ta ketë në institucionet qendrore, me vendet e rezervuara që do t'ia garantoni dhe do t'ia rritni pakicën serbe, ai do të jetë i përfaqësuar me të drejtë vetoje brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërkohë që institucionet qendrore të Kosovës nuk kanë të drejtë madje as ta iniciojnë procedurën e shpërbërjes së këtij asociacioni. Pra, asociacioni do të jetë më i pavarur sesa që është vetë Kosova.

Dhe, çështja tjetër që po ndodh me këtë marrëveshje, e që besoj edhe ju e keni marrë vesh, është që këtu po ndodh sovraniteti i dyfishtë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pra, sovraniteti po ndahet në Kosovë ndërmjet pushtetit të Kosovës dhe pushtetit të Serbisë. Tash e tutje, asnjë vendim nuk do të merret dhe nuk do të mund të merret nga institucionet qendrore të Kosovës, që nuk është në përputhje me kërkesat e Serbisë. Dhe, në këtë drejtim, Kosova tash e tutje nuk mund ta marrë as vendimin më të thjeshtë pa e pyetur pushtetin në Beograd.

Nëse doni fakte, referojuni datës së zgjedhjeve lokale, të cilën na e caktoi Daçiçi, e s'mundi të na e caktojë Presidentja për plot 4 muaj, sa është duke bërë diskutime.

Pra, po e shihni çka po ndodh Kosovës me marrëveshjen. Nuk mund të thoi nesër, 'nuk e paskemi ditë', se tash më i kemi sinjalet shumë të qarta, që në veri do të qeverisin kriminelët, ndërkohë që përmbi Kosovë do të qeverisin edhe kriminelët e Beogradit, e kjo është shumë e qartë.

E tash, votojeni ju marrëveshjen, ratifikojeni marrëveshjen për hatër të Amerikës, për hatër të Britanisë, për hatër të shefit tuaj!

Mirëpo, ta keni parasysh që ne këtë nuk jemi duke e bërë për hatër të qytetarëve të Kosovës. Ne jemi në kundërshtim me vullnetin e tyre, dhe në kundërshtim me krejt sakrificën e këtij populli për t'u çliruar një herë e përgjithmonë nga Serbia, sepse kjo marrëveshje po e kthen praktikisht Kosovën nën tutelën politike të Serbisë, e kjo është shumë e qartë.

Një çështje tjetër, se u përmend këtu disa herë dhe disa herë e keni përmendur 'bashkësia ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare', sot është edhe një parlament tjetër që mban mbledhje ku do të diskutohen edhe këto çështje. E ju e dini shumë mirë cili është. Është Bundestagu gjerman. Bundestagu Gjerman sot do të kërkojë nga Qeveria e Gjermanisë që të mos ia japë datën e saktë Serbisë për fillimin e negociatave për aderim në BE pa e ndryshuar ajo qasjen karshi Kosovës. E tash, ne jemi mbledhur sot këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ta ratifikojmë një marrëveshje, në mënyrë që edhe këtë pozicion mbrojtës, përkrahës, që e ka Gjermania për Kosovën, ne t'ia minojmë atë, t'i themi që në fakt mos u brengosni ju, se puna këtu është mirë.

Është mëkat se si Parlamenti i Gjermanisë po e përfaqëson në njëfarë mënyre më mirë interesin e Kosovës në këtë drejtim, sesa që e përfaqësoni ju deputetë, e veçanërisht që po e përfaqëson kjo Qeveri.

Është për të ju ardhur turp se si po e pranoni këtë gjendje dhe është për të ju ardhur turp se si keni kaluar përmbi qytetarët e Kosovës që i tërheq zvarrë Policia e Kosovës për të hyrë këtu në Kuvend për ta miratuar këtë marrëveshje, e cila Kosovën po e kthen në Serbi.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Blerim Shala e ka fjalën.

BLERIM SHALA: I nderuari kryetar,
Kabinet qeverisës,
Deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Sot po debatojmë këtu për Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kemi të bëjmë me një marrëveshje ndërkombëtare, sepse ndryshe nuk mund të cilësohen këto bisedime dhe rezultati final i tyre kur dihet kontesti politik i kësaj ndërmarrjeje, që prihet nga Ketrin Eshton.

Një shekull i tërë tej mase i gjatë i historisë tragjike në këto relacione dhe 14 vjet të plota të shkëputjes faktike të veriut të Kosovës duhet të zhbëhen me jetësimin e këtij ligji. Mbase për këtë shkak, ky ligj e ka një domethënie të jashtëzakonshme. Ai synon pra ta arkivojë njëherë e përgjithmonë një histori të vjetër në një tjetër të re, të ndodhur në veriun e Kosovës që prej vitit 1999 e këndeje, në emër të një politike që tek duhet të bëhet, tek duhet të ngjajë, gjithnjë me synime të qarta të Republikës, që Republika e Kosovës të jetë plotësisht sovranë në territorin e saj dhe që Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë të mos e pengojnë rrugëtimin e njëra-tjetrës kah Bashkimi Evropian.

Duhet të jemi të sigurtë ndaj njëri-tjetrit dhe të themi që implementimi i kësaj marrëveshjeje është një sprovë e madhe për autoritetin e Kosovës dhe për atë ndërkombëtare, qofshin ato në Prishtinë, apo në Bruksel.

Gjithsesi, edhe këtë duhet thënë, jetësimi i saj në masë të madhe varet prej gatishmërisë së autoriteteve të Beogradit për ta bërë atë që kanë thënë, atë për të cilën janë zotuar dhe atë që e kanë nënshkruar në marrëveshjen e 19 prillit dhe në planin e zbatimit të 22 majit.

Do të ketë probleme të shumta edhe në rastin më të mirë, pra në variantin e bashkëpunimit të mirëfilltë dhe të sigurtë në këtë trekëndësh.

Por, një gjë është shumë e qartë. Prej 19 prillit e këndeje kemi hyrë si Kosovë në një proces të pakthyeshëm të integritit të plotë të veriut, ndërsa Serbia ka hyrë po ashtu në një ndërmarrje të pandalshme të daljes nga territori i Kosovës, duke e siguruar edhe me këtë marrëveshje të drejtën për të interesuar për komunitetin serb të Kosovës nëpërmjet mekanizmave ekzistues, kushtetues, ligjorë të Kosovës, zaten e drejtë kjo e cila është garantuar me pakon e presidentit Ahtisari dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, nëse këtu flasim për qartësinë, e cila rëndom nuk i përcjell proceset e këtilla të ndërlikuara politike në fillim, por gjithsesi gjatë vetë jetësimit të tyre, në Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë ngërthehen përvojat e njohura nga bisedimet e këtij lloji.

Këto përvoja flasin për domosdoshmërinë e një periudhe kalimtare, prej gjendjes së trashëguar, tek ajo synuar, e në rastin e raporteve të Kosovës dhe Serbisë, si gjendja e sotme, është ajo që duhet të arrihet, kanë adresa të qarta të përgjegjësisë dhe të obligimeve.

Në rastin e jetësimit të këtij ligji kemi të bëjmë me ndryshime për të mirë të gjendjes në veri dhe me përmbylljen e shtrirjes së sovranitetit të Kosovës, që mundëson qëndrueshmërinë afatgjatë të Kosovës në këtë segment shumë të rëndësishëm.

Në variantin e synuar me planin për zbatimin e marrëveshjes së parë të 19 prillit do të duhen 180 ditë për jetësimin e saj, por të mos mashtrohem. Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi do të kërkojë shumë vite, të cilat do të dëshmojnë se sa ka aftësi, gatishmëri dhe vullnet politika serbe ta heqë qafe njëherë e përgjithmonë politikën e gabuar të saj dhe tragjike për popullin e Kosovës.

100 vjet lufte dhe konflikti të të gjitha llojeve nuk mund të zhbëhet dot për 100 ditë. Por, 100 ditët e ardhshme, sipas të gjitha gjasave, do të jenë vendimtare për fatin e kësaj marrëveshje dhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve, apo të raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për Qeverinë,

Për deputetët,

Dhe për korin diplomatik, i cili gjendet sot këtu së bashku me ne në seancë.

Duke marrë parasysh se ne e kemi miratuar edhe një herë një marrëveshje të tillë, që nga prilli i këtij viti, dhe nëse e shohim gjendjen faktike, e cila ndodhet tani për tani, pas këtyre bisedimeve maratonike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, atëherë mund të themi se pritët që pas këtij Projektligji për ratifikimi të marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve për rregullimin e normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, zbatimin e saj me përkrahjen e shteteve të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur dihet mjaft mirë se 14 vjet pas luftës, në pjesën veriore të Kosovës nuk kemi pasur zbatueshmëri të ligjit dhe Kushtetutës.

Në parim, Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, nënkryetari Petar Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani članovi Vlade,

Koleginice i kolege poslanici,

Naravno i za današnju sednicu, kao i uvek do sada kada smo raspravljali o ovako važnim temama, pripremio sam govor i da govorimo o detaljima i Nacrta zakona i Plana implementacije, međutim nakon onoga što se dogodilo poslanicima Samostalne liberalne stranke ispred Skupštine Kosova, ja ću reći samo par reči o sporazumu.

Osim glavnog dela sporazuma, to je normalizacija odnosa između Prištine i Beograda, normalizacija odnosa između naroda, pre svih Srba i Albanaca, ovaj sporazum treba da obezbedi Evropsku perspektivu i Kosovu i Srbiji, a to znači perspektivu i usvajanje standarda koje Evropska Unija nosi sobom.

To svakako nije napad na poslanike, dakle pripadnici “Samoopredeljenja” su nas danas napali na ulazu ovu Skupštine. Dakle, počupali su našu koleginicu Jelenu za kosu. To ste uradili vi kolege iz “Samoopredeljenja”. Dakle, da li je to ono zašto se mi zalažemo?

Takođe, želim da se zahvalim policajcima Kosovske policije, koji su dali sve da nas zaštite, i zaštitili su na kraju. Bili su jako hrabri i odlučni. O tome, ja im još jednom ovom prilikom zahvaljujem.

O sporazumu smo govorili puno puta. Imalimo priliku, posle svake runde pregovora, da govorimo, kada nas je premijer izveštavao u ovoj Sali, i puno toga smo već rekli. Samostalna liberalna stranka podržava ovaj sporazum. Samostalna liberalna stranka je pred kraja ovog procesa i direktno je učestvovao preko naše predsednika u ovom dialogu, i mi smatramo da je ovaj sporazum i plan implementacije dobar osnov za normalizaciju odnosa Prištine i Beograda, dobar osnov za normalizaciju stanja na severu Kosova, i dobar odnos da i Beograd i Priština, i ceo region krenu ka euroatlanski integracijama. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Pre nego što bih rekao par reči o samom sporazumu, hteo bih i ja da izrazim svoje nezadovoljstvo neprimerenim ponašanjem domostranata, kao i njihovih vođa, koji su pokušali i uspeali da naše kolege povrede danas kada su dolazili na poso.

I hteo bih i ja da se zahvaljim Policiji, koja je dala sve od sebe da se to ne desi.

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” u celosti podržava ratifikaciju međunarodnog sporazuma, koji uređuje normalizaciju odnos između Republike Srbije i Republike Kosova, kao i plan implementacija ovog sporazuma.

Usvojenjem Nacrta zakona o ratifikaciji prvog međunarodnog sporazuma između Srbije i Kosova, kao i njegovog sprovođenje, važno je za obe zemlje, ali važno je i za celi region.

I slobodno možemo reći da je dobar primer, kako se i najveće razlike mogu prevazići upravo kompromisu.

Usvajanjem ovog sporazuma i njegovo sprovođenje, kao i Evropska perspektiva mora biti vodilje ka evropskom putu oboju zemalja.

I zato pozivam poslanike da isti izglasamo. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6”, kryetarja Myfera Shiniq e ka fjalën.

MYFERA SHINIQ: Faleminderit kryetar,

Sayın Başbakan, sayın başbakan yardımcıları, bakanlar, milletvekilleri ve Kosova Cumhuriyeti’nin dost ülke büyükelçileri,

Bugün, Kosova Meclisi’nde çok önemli bir konuyla ilgili toplantımızı yapmaktayız.

Bu toplantıya Kosova Türk milletvekilleri olarak bir saat gecikmeyle girebildik. Bu da Kosova Meclisi dışında Vetvendosye Hareketinin, Kosova Türk milletvekillerinin bulunduğu arabaya taşla saldırısının sebebidir. Bunu da 6+ Parlamenter Grubu olarak kınamaktayız.

Konuya gelince Sayın Başkan, sayın Hükümet temsilcileri, diplomatik kor ve dost ülkelerin temsilcileri

“Vetvendosye” temsilcilerinin Meclis binası önünde “6+” Parlamenter Grup üyelerini

Kosova - Sırbistan arası ilişkilerin normalleşmesini düzenleyen Birinci Uluslararası anlaşmasına dair Yasa Tasarısının raporunu, uluslararası faktörlerin desteğiyle Kosova’da istikrarın, ekonomik kalkınmanın ile refah düzeyinin kaldırılmasını düşünerekten Türk, Boşnak ve Romlardan oluşan “6+ ” Parlamenter Grubu desteklemektedir. Süreç boyunca da desteğimizi destekleyeceğimizi bildirmekteyiz.

Teşekkür ederim

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i pavarur, Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Kuvend ka mbështetur me rezolutat e tij dialogun me Republikën e Serbisë për t’i evituar problemet shumëvjeçare, njëqindvjeçare në marrëdhënie ndërmjet dy vendeve dhe hapur një proces të normalizimit të këtyre marrëdhënieve.

Rezoluta e Kuvendit, me të cilën kryeministri është autorizuar të nënshkruajë marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve, shpreh këtë disponim të Kuvendit, të deputetëve dhe të skenës politike të Kosovës. Megjithatë, fatkeqësisht procesi i normalizimit dhe procesi i zbatimit të marrëveshjes po shihet se po shkon vështirë nga pala tjetër.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, pala tjetër duhet të tregojë një vullnet më të madh, një qëndrim më konstruktiv për të avancuar procesin e normalizimit. Shumë qëndrime që i shohim nga pala tjetër lidhur me energjinë, telekomunikimet që kanë kaluar afatet, domethënë i zgjidhjes së këtyre problemeve, pjesëmarrjen e Kosovës në tubime ndërkombëtare e deri te edhe pengimi i sportistëve për të marrë pjesë në gara ndërkombëtare, janë shenja jo të mira, sepse pala tjetër nuk e ka marrë seriozisht nevojën për normalizim të marrëdhënieve dhe për të dhënë një kontribut për përmirësimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Bile, ka shenja nga pala serbe që t'i keqpërdorë marrëveshjen dhe bisedat për të tentuar që të demonstrojë një sovranitet të ndarë apo një sovranitet të dyfishtë, kjo është problemi me shpalljen e datës së zgjedhjeve, komandantin e policisë e të tjera. Unë e di se këto janë keqpërdorje të bisedave dhe marrëveshjeve, por këto tregojnë për një disponim, për një qëndrim të Serbisë për t'u infiltruar, për të tentuar që ta ndajë sovranitetin me Kosovën në atë pjesë të vendit tonë.

Mendoj se Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të jenë më energjike që t'i pengojnë këto tendenca. Kur e kemi biseduar marrëveshjen në mënyrë ekzakte kemi shprehur se ky është një rrezik latent dhe Qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare, sidomos Bashkimi Evropian duhet të jenë shumë më energjike, që t'i evitojnë këto tendenca të Serbisë për të ndarë sovranitetin në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës.

Duhet të jetë e vetëdijshme edhe Serbia edhe të tjerët aktorë në politikën ndërkombëtare se një ndarje e sovranitetit në territorin e Kosovës nuk do të krijojë paqe dhe stabilitet, në qoftë se e njëjta gjë nuk ndodh edhe në Luginën e Presheves.

Ne jemi të hapur të bisedojmë, por nuk besoj që ndarja e sovranitetit edhe është zgjidhje dhe këtu duhet të jemi shumë të qartë, kur të shkojnë më tutje me biseda me Serbinë dhe më tutje në mënyrë shumë konstruktive, shumë të hapur për përmirësimin dhe forcimin e marrëdhënieve fqinjësore në të dy vendet. Në këtë drejtim në tekstin e marrëveshjes, unë kam parë se është përmirësuar pak edhe gjuha, megjithatë tek çështjet e ekonomisë, te neni 4 tash teksti në gjuhën serbe është përmirësuar, është bërë pak më i mirë, prej “puni nadzor” është bërë “uvid”, kështu që pak më shumë i përgjigjet fjalës angleze “overview”, por për çudi teksti në shqip është prishur, është bërë “mbikëqyrje e plotë”.

Nuk mund të ketë asociacioni mbikëqyrje të plotë në zhvillimin ekonomik, ju lutem, prandaj duhet të harmonizohet teksti edhe në gjuhën shqipe, qysh është në gjuhën serbo-kroate. Unë përkrah Komisionin për Legjislacion që ka evituar Planin e veprimtimit që të jetë pjesë e këtij ligji që ka qenë një non sens, prandaj mendoj se ai ka bërë shumë mirë dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se ratifikimi i marrëveshjes mund të jetë një interes për

t'i dhënë këtij dokumenti një subjektivitet ndërkombëtar, gjë që për Kosovën ka rëndësinë e vet, nuk mund ta mohojmë këtë. Megjithatë, nuk mund t'i japim këtë karakter me një akt të njëanshëm. Shpeshherë, aktet e njëanshme kanë qenë produktive për Kosovën, por edhe afati i përdorimit të akteve të jo njëanshme, me kohë mund të tregohet kundër produktiv.

Nuk besoj që ne duhet në mënyrë jo kritike të vazhdojmë me akte të njëanshme, andaj unë propozoj që ligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të hyjë në fuqi, pasi edhe pala tjetër ta ratifikojë, Republika e Serbisë edhe në qoftë se duhet edhe BE-ja.

Andaj, zoti kryetar, sot propozoj që këtë tekst, këtë amendament ta merrni në konsiderim e ta veni në votim si pjesë të ligjit, që në nenin 3, pas fjalës “marrëveshja hyn në fuqi” të shtohen “pas ratifikimit edhe nga pala tjetër, Republika e Serbisë” dhe teksti vazhdon më tutje.

Në këtë mënyrë ky Kuvend tregon seriozitetin e vet se respekton synimet e tij për t'i normalizuar marrëdhëniet fqinjësore me Serbinë.

Nën 2, tregon se vlerëson edhe sugjerimet e bashkësisë ndërkombëtare dhe miqve ndërkombëtarë dhe

Nën 3, eviton improvizimet, të cilat mund të jenë të dëmshme në ratifikimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryesues dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në vitin 1989, pikërisht në këtë objekt ku jemi ne, pikërisht këtu ku jeni ulur ju, ishin ulur deputetët e Kosovës, të cilët i thoshin vetes përfaqësues të popullit. Edhe atëherë shumica mendonin se përnjëmend po i përfaqësojnë interesat e Kosovës, por kur erdhi puna që vërtet të mbrohet interesi i Kosovës, kundër qëllimit të Serbisë për ta anuluar autonominë e Kosovës, secili e tregoi veten e vet, se a është me popullin apo është kundër tij, se a është me Kosovën apo kundër interesave të saj?

Dhe e dimë të gjithë se çfarë ndodhi. Shumica e deputetëve pat votuar sipas interesit të Serbisë dhe të Milosheviqit dhe ky vendim, a e dini se si kualifikohej atëherë? Thuhej, që vendimi është marrë me shumicë demokratike.

Sot, të nderuar zonja dhe zotërinj, sfida është po e njëjta, ndonëse në formë tjetër, ta votojmë një marrëveshje që i mbron interesat e Serbisë, apo të mos e pranojmë realitetin e imponuar kriminel që e ka ndërtuar Serbia në Kosovë me dhunë, me shpërngulje, me dëbime, me vrasje e krime, ma barrikada dhe me kontrabandë?

Sot po vendosim se për çka do të përcaktohem ne si shtet, prandaj sot është një ditë vendimtare për çdo deputet. Ne edhe sot e kësaj dite kur e sjellim në mendje vitin 1989,

me krenari i kujtojmë një shtatë a tetë deputetë të cilët e patën guximin në atë kohë të vështirë për t'i dalë kundër Jugosllavisë së madhe e të fuqishme, por me urrejtje të madhe i mbaj mend ata që e ulën kokën dhe paturpësisht u rreshtuan në anën e kundërt të interesit dhe popullit lirishtes të Kosovës.

Dikush e bëri këtë sepse kështu i thanë instancat e larta dhe faktorët vendimmarrës e dikush sepse frikësohej ndoshta mund ta humbte karrigen dhe privilegjet e deputetit. Por shkurt e shqip, secili u dorëzua dhe bëri kështu vetëm sepse i vendosi interesat e ngushta personale përpara atyre të atdheut.

Sot ju do ta vërtetoni se kujt i ngjani më shumë dhe se me vendimin tuaj do ta vulosni vendin tuaj që do ta keni në mbamendjen kolektive kombëtare, sepse do të vendosni nëse do të jeni apo nuk do të jeni sikur Hysamedin Azemi, për shembull.

Po ashtu sot do të vendosni edhe se çka do t'ju pyesin fëmijët apo nipat tuaj pas disa vjetësh. Nëse kjo marrëveshje që po ia legalizon Serbisë pushtetin në veri do ta çojë procesin drejt shpërbërjes më të madhe të kësaj pjese nga Kosova, nëse kjo marrëveshje do të krijojë kushtet e pafavorshme për shtrirjen e sovranitetit tonë dhe do ta çojë veriun drejt ndarjes dhe në fund nëse kjo marrëveshje një ditë do t'i bindë faktorët ndërkombëtarë se autonomia e veriut ndoshta është e paqëndrueshme, prandaj veriu mund t'i bashkohet Serbisë.

A thua, në atë moment qysh do ta ndjeni vetveten? Çka do t'u thonë fëmijëve tuaj në këtë rast, në pyetjen se përse e votuat këtë marrëveshje?

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo marrëveshje e cila sot është hedhur për ratifikim nga ana e Qeverisë e përcakton fatin e shtetndërtimit të Kosovës për 20 apo 30 vjetët e ardhshme. Nëse deri në këtë çast Kosova ka të drejtë legjitime që ta zbatojë Kushtetutën e vet edhe në veri, duke imponuar me institucionet e shtetit sovranitetin e Republikës, po që se ratifikohet kjo marrëveshje, kjo gjë bëhet e pamundur, sepse për çdo veprim në veri duhet të pyetet Serbia, prandaj, rruga e veprimeve të Qeverisë në veri kalon nëpërmjet Beogradit.

Para se të ratifikohet kjo marrëveshje kemi të drejtë të arrestojmë Zvonko Veselinoviçin, pas kësaj marrëveshjeje, jo vetëm që nuk mund ta bëjmë këtë punë, por vjen e na bëhet komandant i policisë shoku i tij, Nenad Gjuriqi.

Aq i etshëm është kryeministri Thaçi për t'i ndrequr punët me Serbinë antishqiptare të Daçiqit, sa që e ka dhënë vizën për emërimin e Gjuriqit ende pa u ratifikuar marrëveshja në Kuvend. Kjo është e tmerrshme.

Tash shtrohet pyetja: A e ka pasur mirë Qeveria kur e ka suspenduar atëherë Gjuriqin, apo tash kur po e emëron komandant të policisë në veri? Kur e ka pasur mirë, shtrohet pyetja?

Shiheni pra se çfarë dorëzimi i Qeverisë dhe çfarë fitore e Serbisë është kjo. Dy herë suspendohet polici i Policisë së Kosovës, që veproi kundër interesave të shtetit tonë, që i zbatoi urdhrat e Vulinit, kurse tash pas negociatave, ai të kthehet në Republikën e Kosovës, me post edhe më të lartë se që e ka pasur dhe të kthehet si komandant i rajonit të Asociacionit, i propozuar dhe i mbështetur nga Serbia.

Unë nuk e di, zonja dhe zotërinj qysh duket ndryshe dorëzimi para Serbisë. Para dy vjetësh, kur patën filluar negociatat ne patëm paralajmëruar se janë dy rrugë për Kosovën e ne ndodhemi në udhëkryq: rruga e sovranitetit dhe ajo e negociatave, tri s'ka. Rruga e sovranitetit është rruga e Enver Zymberit, rruga e negociatave është rruga e Nenad Gjuriqit.

Qeveria është përcaktuar për këtë të fundit. Kryeministri Thaçi e ka zgjedhur rrugën e forcimit të pushtetit politik personal, duke paguar me kartelën e shtetësisë së Kosovës. Prandaj, mos e votoni këtë marrëveshje të dëmshme dhe antikombëtare.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REĐEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Bošnjačka nacionalna zajednica u potpunosti podržava normalizaciju odnosa između dve nezavisne države Kosova i Srbije u interesu stabilnosti i sigurnije bezbednosti, ekonomske perspektive svih građana različitih nacionalnih i verskih zajednica uz poštovanje ljudskih i manjinskih prava, vrednosti različitosti u cilju uspostavljanja pomirenja, mira, tolerancije i nenasilničkog ponašanja. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Qysh në shtator të vitit 2008, pra, para më shumë se 3 vjetëve Lëvizja “Vetëvendosje” pat bërë një propozim me disa hapa të bashkërenduar për ta bërë Kosovën shtet sovran e me integritet territorial. Ja disa nga kryesoret prej tyre:

Nën 1. FSK të shpallet dhe të bëhet ushtri, pastaj menjëherë të iniciohet marrëveshja e SOF-as me NATO-n,

Nën 2. në veri të ketë një prezencë të shtuar të policisë, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme atje. Një bazë e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës të jetë e vendosur në Lagjen e Boshnjakëve në ish- bazën e KFOR-it, përkatësisht ish- remontin ushtarak, dy baza të tjera të Njësisë Speciale së bashku edhe me forcat ushtarake të jenë në afërsi të pikave kufitare 1 dhe 31.

3. Kosova duhet të krijojë marrëdhënie të fuqishme bilaterale me shtetet e veçanta që na e kanë njohur pavarësinë e posaçërisht me Shqipërinë, SHBA-të, shtetet kryesore të BE-së dhe Turqinë.

4. Duhet të ndërpriten përfundimisht dhe zyrtarisht këto bisedime, që po zhvillohen në Bruksel me Serbinë e të cilat, siç e dimë janë bisedime pa kushte për Serbinë dhe për çështjet e brendshme të Kosovës. Me këto bisedime nuk përforcohet pavarësia e Kosovës prej Serbisë, por pavarësia e veriut të Kosovës prej Kosovës. Po ashtu, duhet të bllokohen mallrat e Serbisë në Kosovë dhe të mos lejohet të na i marrë rreth 800 milionë euro në vit.

5. Duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë, duhet zhurmuar dhe duhet prerë financimi i tyre nga Serbia dhe nga krimi i organizuar bizneset informate.

6. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa reciprocitet e simetri të drejtave të serbëve në Kosovë me shqiptarët në Serbi. Shqipëria dhe Kosova bashkërisht duhet të angazhohen për shqiptarët kudo që ata janë e posaçërisht për ata në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Arsyeja kryesore pse Serbia e ka synuar decentralizimin në Anamoravë është që ta hedhë farën e ndarjes dhe izolimit të asaj pjese nga Kosova.

7. Qeveritë dhe kryeministrat e pasluftës janë munduar t'i integrojnë serbët duke iu dhënë ose premtuar mijëra euro kesh, duke iu falur traktorë apo duke iu ruajtur pagat edhe kur ata punonin për Serbinë. Zgjidhja është krejtësisht ndryshe, jo para e privilegje, por zhvillim arsimor, ekonomik dhe barazi para ligjit, jo bisedime me Serbinë e strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitet për shtetin.

8. Rivitalizimi i “Trepçës”, funksionalizimi i saj që do të rezultonte me punësimin e rreth 8 mijë vetave. Kjo do të kontribuonte në bashkimin e qytetit, sepse ndarja në Ibër e ka lënë Mitrovicën e Stari-Tërgut në njërën anë, ndërsa shkritoren, në anën tjetër, Zveçan. Kështu, Mitrovica u shndërrua në qytetin më të varfër dhe ajo është i vetmi qytet në Kosovë, të cilit i është zvogëluar popullsia përgjatë viteve.

9. Ofrimi i bursave për shqiptarët dhe serbët nga veriu për në shkollat e mesme dhe Universitetin në Prishtinë.

10. Investim në Spitalin e Prishtinës dhe atë në jug të Mitrovicës, në mënyrë që aty të ofrohen shërbime më të mira.

11. Forcimi i fshatrave të shqiptarëve dhe lagjeve të Mitrovicës të banuara me shqiptarë në veri, duke u ofruar mjete për rindërtimin e shtëpive, infrastrukturë të mirë, transport publik falas për në jug të Mitrovicës dhe anasjelltas, tri herë në ditë, lehtësim në punësim, lehtësim për regjistrim në Universitet.

12. Vetëm me 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, njëmbëdhjetë shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar ose lëkundur, ndërsa 1 564 familje me 11 364 anëtarë janë

dëbuar. Secili shqiptar i dëbuar duhet të kërkojë të kthehet në pronën e vet në veri dhe njëkohësisht të organizohen dhe mobilizohen për këtë ata që nuk duan.

Duhet ta thonë hapur këtë dhe t'ua shesin të tjerëve pasurinë, atyre që duan të kthehen atje. Qeveria duhet të ndihmojë dhe mbështesë këtë me një program të veçantë.

Dhe pika e 13-të, nuk duhet lejuar që Qeveria e Serbisë t'i blejë pronat e shqiptarëve në veri. Të gjithë shqiptarët që janë të detyruar t'i shesin pronat e tyre, Qeveria e Kosovës do t'ua blejë ato. Serbët do të mund të integroheshin në Kosovë duke pasur parasysh që integrimi ndodh jo se integrimi është dëshirë, por pse integrimi është nevojë. Serbia po përpiqet me të gjitha mënyrat që serbëve t'ua bëjë të panevojshëm integrimin në institucionet dhe shoqërinë kosovare.

Para çfarëdo çështje të serbëve të Kosovës, duhet që paraprakisht të ndërpritet ndikimi i Serbisë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet për mua si deputet, por jo vetëm për mua e për më shumë për qytetarët e Kosovës, sot po e ndiejmë se në Kuvendin e Republikës së Kosovës po bëhet puna më e keqe që ka ndodhur ndonjëherë në këtë Kuvend, prej se është themeluar ky institucion pas lufte.

Për mua personalisht, është ngjarja më e rëndë nëpër të cilën po kalojmë si deputetë dhe njëkohësisht edhe si Kosovë. Kosovës iu ka vu një çmim që nuk i takon. Kosova ka paguar çmim për lirinë, Kosova ka paguar çmim për këtë Kuvend që ta kemi.

Kosova ka paguar çmim shumë të madh me jetët e njerëzve e qytetarëve të këtij vendi, po kurrë nuk do të duhej që Kosovës t'i vihej në barrë që këtë çmim ta paguante me rikthimin e Serbisë në Kosovë në çfarëdo forme.

Njëkohësisht, me këtë marrëveshje apo kjo marrëveshje në tërësi e rikthen Serbinë në Kosovë, e rikthen Serbinë në vendimmarrje për Kosovën dhe këtë po e shihni dhe po e prekni përditë dhe këtë s'mund ta mohojë askush.

Nuk ka turp më të madh se sa Kosova t'i nënshtrohej në këtë situatë Serbisë me një shkallë të tillë të lojalitetit dhe inferioritetit ndaj saj. Dhe, kurajë e cilitdo deputet sot do të ishte ta gjente forcën që të shkëputej nga ky nënshttrim dhe nga ky inferioritet ndaj Serbisë. Në të njëjtën kohë në zhvillimin tonë si Kosovë, jo rrallëherë, madje edhe shumë shpeshherë jemi thirrur në sakrificën e popullit për të arritur dhe për ta avancuar gjendjen dhe çështjen e shqiptarëve në Kosovë, për ta avancuar gjendjen e të gjithë qytetarëve në Kosovë, për ta krijuar një shoqëri të barabartë për të gjithë qytetarët në Kosovë. Por, avancimi i këtij shteti, avancimi i kësaj shoqërie nuk do të duhej kurrë të bëhej duke shkelur mbi ata, të cilët e paguan më së shtrenjti. Pra, e them shumë sinqerisht, nuk ka shkelje më të madhe për qëllimin e atyre njerëzve se sa t'ua vrasësh qëllimin e të sakrifikuarve për ne.

Sot në këtë sallë te kolegët e mi deputetë kam takuar dhe kam vërejtur deputetë që kanë ndjenja të ndryshme, prej atyre deputetëve të cilët refuzojnë me këmbëngulje këtë marrëveshje si të dëmshme për Kosovën, duke kaluar nëpër ata deputetë, të cilët me arsye apo gjejnë një arsye që t'i shmangen grupeve të veta parlamentare dhe urdhrave partiakë të grupeve të veta parlamentare, te ata deputetë të cilët me kokulur thonë se ne nuk kemi qare dhe nuk mund t'i shmangemi këtij votimi e deri te ata deputetë, që me buzëqeshje bëhen avokatë të interesave të Serbisë në Kosovë, shkak se kjo marrëveshje është interes i Serbisë në Kosovë e jo interes i Kosovës përballë Serbisë.

Nuk e di, e përmendi kolegu Konjufca, nuk e di çfarë do t'u thoni fëmijëve tuaj, si do t'ua arsyetoni këtë veprim tuajin fëmijëve tuaj, si do t'ua zbukuroni dhe do t'ua dizajnoni? Vërtet nuk kam kapacitete ta imagjinoj se si do t'ua shpjegoni fëmijëve tuaj këtë marrëveshje si të mirë për Kosovën? Ose, si do t'ua fshihni atyre që kjo marrëveshje ua ka dëmtuar deri në shkallë shumë të rëndë të ardhmen e tyre?

Të nderuar kolegë deputetë, mbani mend, do t'u kujtohet kjo ditë. Mbajeni mend se një ditë do të gjykohet ky veprim i Kuvendit të Kosovës. Ndoshta, dikush mendon që do të gjykohet si akt historik, por edhe historia i ka përparësitë dhe mangësitë e tyre. Ka pasur ngjarje të mira dhe të këqija në histori, prandaj duke e quajtur si ngjarje historike, nuk nënkupton që gjithmonë është ngjarje e mirë historike.

Por, edhe njëherë, mbajeni mend, me këtë ratifikim eventual, të cilin kurrë nuk do të doja ta shihja të ratifikuar në këtë Kuvend, ju vetëm do t'ia nxirrni edhe një telashe më shumë qytetarit dhe popullit të Kosovës, për shkak se kurrë nuk do të jetë as e miratuar, as e respektuar, as e implementuar nga qytetarët e Kosovës. Pra, ju veç po ua nxirrni një telashe më shumë këtij populli që nëpër telashe ka ardhur deri këtu.

Edhe një herë po u drejtohem atyre deputetëve të cilët kanë dyshim ose janë në mëdyshje në mes presionit dhe në mes vullnetit të brendshëm, zgjidheni këtë të dytën.

Ndoshta, për momentin sot do të duket më i vështirë, ndoshta do t'ua lëndojë karrierën tuaj politike, por nuk do t'ua lëndojë të ardhmen tuaj. Në mes të frikës nga qeveritarët dhe të frikës nga qytetarët, më mirë do të ishte e dyta, por mbi të gjitha ne nuk do të duhej të kishim frikë që ta mbrojmë interesin e qytetarëve.

Edhe njëherë ju bëj thirrje, mos iu nënshtroni të nënshtruarve, për shkak se nënshtrimi do të jetë i dyfishtë, është nënshtrim i dyfishtë nëse iu nënshtroheni të nënshtruarve. Zgjidhni të dytën, respektoni vullnetin e qytetarëve, respektoni të ardhmen e mirë të qytetarëve e mbi të gjitha respektoni atë çfarë vetë e keni shpallur në këtë Kuvend, në vitin 2008. Pra, respektoni së paku atë shtet që e keni shpallur, mbron atë shtet që e keni shpallur që ta avancojmë, mos u ktheni mbrapa!

Mos u ktheni mbrapa, për shkak, se siç thashë edhe njëherë, vetëm një telashe më shumë do t'ia nxirrni qytetarëve e mbi të gjitha, qytetarët kurrë nuk do ta pranojnë si të veten këtë marrëveshje.

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Nuk ka më asnjë fije dyshimi që marrëveshje Thaçi-Daçiq është tejet e dëmshme për vendin dhe qytetarët, andaj në asnjë mënyrë nuk guxojmë të lejojmë që ky Kuvend të ratifikojë një marrëveshje aq të dëmshme dhe antikushtetuese, e cila e cenon sovranitetin dhe integritetin territorial.

Rekomandimi i Komisionit për Legjislacion që na është sjell sot, është i turpshëm. Ky rekomandim tregon joseriozitetin dhe papërgjegjësinë e këtij Komisioni, pasi që ky Komision sipas Kushtetutës dhe Rregullores së punës është përgjegjës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të projektligjeve, të vlerësojë pikë për pikë, secilin akt që vjen pranë tij.

Mirëpo, ajo se çfarë ndodhi është se anëtarët e këtij Komisioni qëllimisht mbyllën sytë karshi këtyre shkeljeve flagrante të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër, e kundërshtuan edhe propozimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” për vlerësim paraprak të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese.

Me rekomandimin e propozuar nga Komisioni për Legjislacion janë të parapara 3 amendamente, që janë tejet qesharake e që kanë të bëjnë me heqjen e planit të zbatimit nga ky projektligj. Po e them edhe njëherë, heqja e planit të zbatimit nga projektligji nuk e zbeh thelbin e kësaj marrëveshje të dëmshme dhe antikushtetuese. Plani i zbatimit rrjedh nga marrëveshja dhe si i tillë është reflektim i çështjeve të dakorduara në marrëveshje.

Çdo plan i zbatimit që do të rridhte prej tekstit të kësaj marrëveshjeje do të ishte njëjtë i dëmshëm. Pra, miratimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes edhe pa planin e zbatimit, nuk na shpëton nga dëmet dhe antikushtetutshmëria e saj. Pra, problemi zanafillor është vetë marrëveshje. Ajo në princip na e shpërfytyron shtetin e na pamundëson të ardhmen e sovranitetit.

Për më tepër, ky plan i zbatimit është edhe i jo i plotë edhe i tejkaluar tashmë, prandaj edhe është në interesin e Qeverisë që ta heqë nga ky projektligj. Janë të paktën pesë çështje që janë antikushtetuese në këtë projektligj, rrjedhimisht në këtë marrëveshje, të cilat do t'i përmend me radhë:

Fillimisht krijimi i Fondit zhvillimor për veriun i ndarë nga buxheti i shtetit bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

Ligji për financat publike dhe përgjegjësitë, është hartuar në frymën e nenit 1, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës, i cili ndër të tjera thotë se Republika e Kosovës është shtet unik. Pra, kjo nënkupton që edhe sistemi financiar duhet të jetë unitar;

Krijimi i Fondit në parim bie ndesh edhe me nenin 120, paragrafi 1 të Kushtetutës, kjo ngase sipas kësaj dispozite janë të parapara në mënyrë strikte parimet mbi të cilat

menaxhohen financat publike e këto parime përkojnë me llogaridhënie, efektshmëri dhe transparencë;

Në këtë mënyrë duke iu referuar edhe Ligjit për financat publike dhe përgjegjësitë, Fondi i veriut bie ndesh edhe me nenin 17, paragrafi 1 dhe 2, sepse këto mjete nuk kalojnë procedurën e miratimit dhe projektimit buxhetor dhe kështu vjen deri te shkelja e parimit kushtetues të efektshmërisë dhe transparencës. Si dhe nenin 18, paragrafi 1, i cili parasheh një llogari të vetme, në të cilën menaxhohen mjetet financiare të Buxhetit të Kosovës.

Më tej, themelimi i asociacionit të komunave serbe të Kosovës shkel rregullimin e brendshëm të Republikës sonë. Duke u nisur nga koncepti kushtetues i shprehur në nenin 1, paragrafin 1 të Kushtetutës, në të cilin theksohet se Republika e Kosovës është shtet sovran, i pavarur, demokratik, unik dhe i pandashëm, pra edhe themelimi i Asociacionit me kompetencat e parapara në këtë marrëveshje, bie ndesh me këtë dispozitë

Kjo gjithashtu bie ndesh edhe me nenin 123, paragrafi 1 dhe nenin 124 të Kushtetutës, sepse fryma e rregullimit duhet të jenë interesat e përbashkëta të komunave, por këto interesa nuk mund të merren parasysht vetëm për një komunitet etnik dhe e gjithë kjo të jetë në dëm të një grupi tjetër etnik.

Këtij asociacioni po i jepen kompetenca të tilla, që konstituojnë me një trup politik me organizim institucional të ndryshëm nga pjesa tjetër e Kosovës. Ky asociacion do ta ketë presidentin, zëvendëspresidentin, Kuvendin, Këshillin, pra po krijohet një strukturë paralele në nivel shtetëror. Ky Asociacion për veç krijimit të tij ka të drejtën edhe për zgjerim, i instalohet e drejta e vetos për shpërbërje.

E kemi thënë me mijëra herë, por po e përsëris prapë, presidenti mund ta shpërbëjë Kuvendin, por jo edhe këtë asociacion. Edhe kryeministri e shpërbën Qeverinë përmes dorëheqjes, por jo edhe këtë asociacion, sepse i njëjti shkarkohet me dy të tretat e anëtarëve të po këtij asociacioni e që kjo nuk do të ndodhë asnjëherë.

Për më tepër, nuk dihet se në bazë të cilave ligje do të funksionojë ky asociacion, ose dihet, meqë në marrëveshjen Kosovë - Serbi, përmendet ligji kushtetues, por sistemi jonë kushtetues është sistem i kodifikuar, ndërsa në anën tjetër Serbia ka sistem partikular, ku krahas Kushtetutës së saj organi ligjvënës mund të nxjerrë edhe Ligjin Kushtetues. Pra, kjo nënkupton që ai asociacion do të zbatojë dhe do të veprojë në bazë të Ligjit Kushtetues që do të nxirret nga Serbia.

Më tej, pikat 7, 8 dhe 9 të marrëveshjes kanë të bëjnë me strukturat e sigurisë. Inkuadrimi i strukturave paralele të sigurisë tërheq pas vetes një sërë çështjesh që krijojnë rrethana me të cilat vihet deri te kundër kushtetutshmëria e kësaj marrëveshjeje. Pra, kjo bie ndesh edhe me nenin 125, paragrafi 1 të Kushtetutës, mirëpo edhe me paragrafin 2, i cili thotë që institucionet e sigurisë duhet ta pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.

Pra, përfshirja e strukturave paralele është në kundërshtim me këto dispozita, ngase si të tilla ato nuk e pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike, por krijohen pikërisht për strukturimin e një përkatësie etnike.

Kjo marrëveshje po i legalizon strukturat kriminale të Serbisë dhe amnistion bartësit e institucioneve antikushtetuese e të paligjshme të përfaqësuesve të Beogradit që veprojnë në Kosovë.

Zotimi i Hajredin Kuçit, në cilësinë e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, për efektet juridiko-praktike në lidhje me institutin e amnistisë, është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në kompetencat e sistemit të drejtësisë.

Në rregullimin juridiko-penal, amnistia shpallet për persona që kanë kryer veprë penale dhe për veprën e kryer në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë është shqiptuar dënimi konform legjislacionit penal në fuqi.

Çdo formë e amnistimit jashtë sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës është arbitrar, në kundërshtim me ligjet dhe përbën në vetvete përgjegjësi, përveç se politike e morale, edhe penale.

Për më tepër kjo për çfarë është zotuar kryeministri dhe zëvendëskryeministri është në fakt amnistim i krimit të kryer nga strukturat ilegale të Serbisë dhe inkurajim për krime të reja.

Së pari duhet të vendoset drejtësia për krimet e bëra, e më pas duhet të zhbëhen strukturat ilegale.

Themelimi i njësisë së veçantë të Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me nenin 102, paragrafi 1, i cili thotë se sistemi gjyqësor është unik, i pavarur dhe krahas epitetëve të tjera, siguron qasje të barabartë.

Nuk mund të flitet për qasje të barabartë, kur në aspektin e kompetencës lëndore, marrëveshja përcakton dy trupa të veçantë të Gjykatës së Apelit, të cilët do të merren me rastet të cilat vijnë nga komunat, siç është theksuar, me shumicë serbe.

Në pikën 11 të marrëveshjes thuhet që zgjedhjet lokale do të organizohen me ndihmën e OSBE-së.

Edhe kjo pikë është kundërkushtetuese, konkretisht meqë neni 139 thotë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Pra, Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka dhënë autorizim kushtetues vetëm KQZ-së, që në cilësinë e organit të përhershëm t'i njihen kompetencat ekzekutive për organizimin e zgjedhjeve.

Ne si subjekt politik, do t'i përdorim të gjitha mjetet për ta kundërshtuar këtë marrëveshje të dëmshme, mirëpo po ju bëj thirrje edhe juve, të nderuar deputetë, që të reflektoni drejt dhe ta kundërshtoni këtë projektligj. Pra, ne duhet ta ndalim së bashku këtë marrëveshje dhe dëmet që rrjedhin prej saj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Të dashur qytetarë të Republikës të Kosovës, Arsyeja pse po synohet ratifikimi i marrëveshjes Thaçi-Daçiq është e trefishtë. Të dominohen LDK-ja dhe AAK-ja nga PDK-ja. Kjo është pra arsyeja e parë. Thaçi lejon të dominohet nga Eshton dhe Daçiq, sepse kjo ia mundëson t'i dominojë Mustafën edhe Haradinajn. Thaçi është i dominuar në mesin e dominuesve dhe është dominuesi në mesin e të dominuarve.

Arsyeja e dytë pse po synohet sot ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është të minohet rezistenca e Gjermanisë ndaj Serbisë. Ju e dini se Bundestagu Gjerman ia pati vënë 7 kushte Serbisë, njëri prej tyre pat qenë që prapa grilave të dërgohen ata që e dogjën ndërtesën e Ambasadës gjermane në Beograd, në shkurt të vitit 2008. E, ne na i kanë djegur 120 000 shtëpi, asnjë cent nuk na e kanë paguar asnjëherë, ndërkaq një ndërtesë të Gjermanisë e kanë djegur serbët në Beograd dhe Bundestagu as nuk ua harron, e as nuk ua falë.

Dhe, e treta arsye është që kur të bie Qeveria Thaçi, Qeveria e ardhshme t'i ketë duart e lidhura nëpërmjet këtij ratifikimi. Serbisë mbase nuk i intereson pika e parë, mirëpo për dy pikat e tjera, pra pika 2 dhe 3, ajo është shumë e interesuar. Kjo marrëveshje nuk ka ardhur nëpër komisionet e Kuvendit, dhe kështu është bërë një shkelje shumë e rëndë. Në këtë marrëveshje ka gjithçka; zhvillimi ekonomik, arsimi, shëndetësia, policia, gjyqësia, planifikimi urban e rural. Në asnjë komision të Kuvendit të Kosovës nuk janë trajtuar këto çështje, duke u kufizuar te Komisioni për Legjislacion. Mbi të gjitha, Komisioni për Punë të Jashtme është anashkaluar dhe kjo sigurisht e paraqet shkeljen më të rëndë.

Po i përmend dy nga pikat e detyrave të Komisionit për Punë të Jashtme që është sanksionuar në shtojcën 2 të Rregullores të Kuvendit të Kosovës. Fushëveprimi i këtij komisioni, ndër të tjera përfshin: ratifikimin në bllok ose ndaras të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë, përcjelljen e negociatave të udhëhequra nga Qeveria për bashkëpjesëmarrje të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre.

Pika e parë në të cilën pra theksohet ratifikimi i marrëveshjeve të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë, aludon në shqyrtimin paraprak të Komisionit para se cילו nga organet shtetërore ndërmerr nismën për lidhjen e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare. Pra, gjithmonë duhet të merret një mendim i Komisionit për Punë të Jashtme, para se të lidhet marrëveshja nga Kosova.

Pika e dytë i jep kompetencë Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme që t'i përcjellë negociatat e udhëhequra nga Qeveria. Ne e kemi ftuar kryeministrin si kryenegociator që është, më 11 shkurt të këtij viti, që të raportojë në Komisionin për Punë të Jashtme. Jo

vetëm që nuk ka ardhur, por as nuk është përgjigjur. Provuam që ta kemi para ratifikimit edhe ministrin Hoxhaj, por kot. E ftuam më 23 maj, na u përgjigj më 19 qershor nëpërmjet asistentes së tij, sërish duke komunikuar me asistenten e tij të premtën, më 21 qershor. U dakordua që ai të vijë të hënën, por më 24 qershor, pra të hënën, përsëri e anuloi ardhjen.

Po ashtu, pa ardhur pra ministri i Jashtëm në Komisionin për Punë të Jashtme, kurrësi nuk bën të ratifikohet kjo marrëveshje, e mbi të gjitha pa ardhur kryeministri në raportim në Komisionin për Punë të Jashtme, kurrësi nuk bën të ratifikohet kjo marrëveshje. Janë bërë shkelje të rënda në procedurat për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje që po imponohet sot.

Ratifikimi i sotëm pa raportin në KPJ dhe me anashkalim të KPJ-së, është shkelje e rëndë dhe nuk duhet lejuar.

Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmejt Kosovës dhe Serbisë, nuk është marrëveshje ndërkombëtare. Sipas Konventës së Vjenës mbi të drejtën e traktateve ndërkombëtare neni 11, hyrja në një marrëveshje ndërkombëtare bilaterale mund të bëhet vetëm pasi të dyja palët kontraktuale të kenë shprehur dhe dorëzuar njëra-tjetrës instrumentet e pranimit të ratifikimit të marrëveshjes në fjalë. Konventa e Vjenës është fundamenti i të drejtës ndërkombëtare që qeveris dhe rregullon hyrjen dhe daljen në detyrime bilaterale dhe multilaterale të shteteve dhe çështjet e rregullimit dhe të interpretimit të traktateve i nënshtrohen asaj në mënyrë të plotë.

Serbia, marrëveshjen në fjalë, nuk e konsideron marrëveshje ndërkombëtare dhe e ka miratuar thjesht dhe vetëm në qeverinë e saj. Kjo do të thotë që Serbia marrëveshjen në fjalë e konsideron të thjeshtë dhe vetëm akt nënligjor, as edhe një akt në nivel të ligjit, që i përgjigjet konceptit të saj, që marrëveshja në fjalë është një akt i brendshëm i Serbisë. Mosnjohja e karakterit të marrëveshjes ndërkombëtare për këtë marrëveshje e bën të pakuptimit që pala tjetër njëanshëm t'ia njohë asaj këtë status juridik, meqë një gjë e tillë mund të njihet vetëm pas pajtimit bilateral të palëve.

Pse po i ngutet Thaçit që ta ratifikojë marrëveshjen? Pse ai nuk po thotë 'le ta ratifikojë njëherë Kuvendi i Serbisë'. Ky kryeministër duhet të përgjigjet, pse nuk po presim derisa ta ratifikojë Kuvendi i Serbisë njëherë marrëveshjen? Ratifikimi eventual i Kuvendit të Kosovës për një marrëveshje të tillë është i palogjikshëm dhe multilateral. Serbia në asnjë rrethanë nuk e ka pranuar që një marrëveshje e tillë të konsiderohet si marrëveshje ndërmjet dy shtetesh. Sipas Konventës së Gjenevës mbi të drejtën e traktateve, neni 13 dhe 14, ratifikimi në Kuvendin tonë është i palogjikshëm dhe përbën ratifikim të një akti që Serbia e konsideron të ketë karakter të brendshëm nënligjor.

Marrëveshja 15-pikëshe Thaçi-Daçiç nuk e ka formën e as formatin e marrëveshjes ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës nuk e dërgoi atë në Gjykatën Kushtetuese për verifikim. Kjo marrëveshje nuk është përnjëmend e nënshkruar, por vetëm e parafuar me initiale në dy dokumentet e ndara. Pra, njëri dokument mban initialet e kryeministrit të

Kosovës Thaçi e të Baroneshës Eshton, kurse tjetri të Baroneshës Eshton dhe të kryeministrit të Serbisë, Daçiq.

Në fakt, kjo marrëveshje është edhe më e varfër se kaq. Të gjithë i kanë vënë inicialet e tyre si persona, si individë, e jo si krerë shtetërorë, apo përfaqësues politikë.

Dihet që Serbia nuk e njeh Kosovën, nuk e pranon pavarësinë e Kosovës, prandaj ajo mund ta pranojë Qeverinë e Kosovës, por jo Republikën e Kosovës, dhe rrjedhimisht jo Qeverinë e Kosovës si Qeveri të Republikës të Kosovës. Kjo marrëveshje nuk është ndërkombëtare, ajo edhe cilësohet, lexohet dhe quhet ndryshe nga palët. Këtu nuk ka marrëveshje as për titullin dhe emërtimin e marrëveshjes. Qeveria e Kosovës po e quan marrëveshje e parë e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës të Kosovës dhe Republikës të Serbisë, por Serbia dhe qeveria e saj nuk e quajnë kështu.

Për më tepër e për më keq, marrëveshja ka nisur të zbatohet pa u ratifikuar. Kjo është po ashtu një shkelje e rëndë. Është emëruar për shembull Nenad Gjiriqi si komandant i Policisë për rajonin e veriut. Milazim Mustafa, një ish i burgosur politik nga Obria e Ulët, që i bie me Skenderajn. Unë disa muaj kamë qenë në burg me Milazim Mustafën. Edhe vëllezërit e tij, Përparimi dhe Halili, kanë qenë në burg.

Në burgun e Pozharevcit, ne e kemi kaluar pjesën më të rëndë që e kanë pasur shqiptarët në atë periudhë, por unë dua ta them edhe një gjë: se Milazimin, ndërmjet 27-30 shtator të vitit 1998, kur ka qenë në stacionin e policisë në Mitrovicë, për 72 orë para paraburgimit, e ka marrë në pyetje dhe e ka torturuar Dragan Gjuriqi, vëllai i Nenad Gjiriqit, dhe e kemi sot në gazetën “Koha Ditore” një shkrim për këtë. Nenad Gjiriqi ka qenë po ashtu polic në atë kohë dhe nëse Milazimin e ka torturuar njëri vëlla, është kollaj e imagjinueshme që një Milazim tjetër e ka torturuar pikërisht Nenadi.

Unë e di që ju vazhdimisht po thirrreni, deputetë të PDK-së, ‘kemi kontribuar, kemi kontribuar, kemi sakrifikuar, kemi kontribuar’, por po del që ky kontribut ka qenë investim. Meqenëse tash po e kërkon edhe kthimin, edhe fitimin. Angazhimi për çështje kombëtare është obligim, borxh i secilit prej neve sa të jemi gjallë. Të vetmit që e kanë kryer obligimin janë dëshmorët e kombit.

Ne që kemi mbetur gjallë, duhet punuar tërë jetën. Jo tash të kërkojmë fitim edhe kthim të investimit. E kjo është logjikë e biznesit, por për mua nuk është e çuditshme, se disa prej jush që jeni zyrtarë të lartë të PDK-së, që thonë se jeni komandantë, keni qenë komandantë një vit e 14 vjet biznesmenë. Nuk është 14 vjet komandant lufte, e një vit biznes, por një vit komandant e 14 vjet në biznes. Prandaj, unë edhe kam harruar kur keni qenë ju komandantë.

Dhe, tjetra që desha të them është se pasojat e kësaj marrëveshjeje janë afatgjata dhe të gjitha këto pasoja i bartin edhe brezat e ardhshëm, prandaj nuk është në rregull që ky Kuvend ta ratifikojë këtë marrëveshje. Për datën 3 nëntor, askush nuk është i pëlqimit që të jenë zgjedhjet lokale. “Vetëvendosje” ka kërkuar datën 29 shtator, ose 6 tetor. Kryeministri, duke e thumbuar kryeparlamentarin Krasniqi, i tha ‘ne nuk mundemi t’i

bëjmë për Bozhiq, edhe për Shëngjergj zgjedhjet'. Me kryeparlamentarin e pati atë fjalë, mirëpo ky po ia bënë për 'Vidovdan' një dhuratë të shkëlqyeshme Daçiqit, të cilit i është bërë shërbëtor super i dëgjueshëm.

Edhe një herë pra, tri arsye pse po ratifikohet kjo marrëveshje e imponuar prej Qeverisë: E para, duan ta dominojnë LDK-në dhe AAK-në; e dyta, duan ta minojnë rezistencën e Gjermanisë, dhe e treta, kur të bjerë kjo Qeveri, këta janë të interesuar që edhe Qeveria e ardhshme t'i ketë duart e lidhura. E këtë e do më së shumti Serbia.

Faktorëve ndërkombëtarë që janë larg dhe në fund, u kisha bërë thirrje: mos e përkrahni "Vetëvendosjen"! Nuk keni nevojë ta përkrahni "Vetëvendosjen", por fliteni të vërtetën për këta kriminelë, se ju e dini shumë mirë kush janë këta. Ju e dini korrupsionin, krimin e organizuar dhe i dini të gjitha krimet që i kanë bërë...

KRYTARI: Të lutem, të lutem! Tërhiqe fjalën!

ALBIN KURTI: ...pra, ju thojeni të vërtetën. Ambasadorja amerikane, zoti Zhbogar, të gjithë ambasadorët, ju e dini çfarë kriminelësh janë këta prapa meje, por ju duhet të flisni. Fliteni të vërtetën! Nuk ka nevojë ta mbështetni "Vetëvendosjen".

(Ndërprerje nga regjia, diskutim pa mikrofon.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Erdhi pra radha edhe një herë që të diskutohet në lidhje me ratifikimin e asaj që po quhet marrëveshje historike për Kosovën. Unë po pajtohem se është historike, pasi në historinë tonë nuk mbajmë mend të ketë marrëveshje më të turpshme.

Kjo marrëveshje po pritët të votohet nga ju, të nderuar deputetë, dhe unë jam i bindur që të gjithë ju e keni mjaftë të qartë dëmin e saj. Dhe, nga të gjitha grupet parlamentare, disa nga ju e kanë thënë këtë publikisht këtë, disa nga ju na e kanë thënë intimisht, e me disa nuk flasim fare.

Nga të gjitha grupet parlamentare, unë te ju gjej veprimtarë që kanë vepruar e frymëzuar të tjerë, e të cilët nuk kanë të bëjnë me këtë marrëveshje. Nuk ka të bëjnë as veprat tuaja në të shkuarën, e as bindjet tuaja atëherë, e madje as sot. Marrëveshja nuk buron nga këtu, ajo është sjellë nëpërmjet agjendave të huaja dhe ka gjetur hapësirë këtu. Kjo nuk është marrëveshje juaja, kjo është marrëveshje e një njeriu, kjo është marrëveshje e Hashim Thaçit.

Po vjen puna që e tërë puna e palodhshme përgjatë një shekulli e njerëzve tanë, avancimi gradual me gjak përgjatë dekadave, në forma të ndryshme të degradojë në këtë marrëveshje nga ky njeri. Si u bë kjo?

Ju e njihni mirë Hashim Thaçin, por unë dua të ju përkujtoj se si figurë me ndikim në lëvizje atë e ka bërë në fakt të qenit në kontakt i shërbimeve të jashtme. Pra, ai ka qenë i

aktivizuar, ama faktor e bëri ky kontakt, lidhja e tij. Dhe, ky kontakt, pjesërisht i pranuar nga vetë ai, ndonëse jo i qartësuar në rrugën atij.

Në vitet e '90-ta, para se të fillonin aksionet më intensive, në qarqet e Lëvizjes, e posaçërisht në diasporë dominonte ideja e krijimit të një fronti të përgjithshëm politik në luftë kundër pushtuesit dhe ky front do të bashkonte në një trup faktorë të ndryshëm politikë, do të kishte program të qartë për kryengritje dhe natyrisht do ta kishte edhe ushtrinë i instrument.

Në lëvizjen në diasporë, e posaçërisht te pjesa në Gjermani dhe në Zvicër, ky ishte koncepti qendror. Ndiqej modeli i Kroacisë, përpjekjet dhe përvojat e saj në çlirimin dhe në ndërtimin e shtetit. Ky koncept nënkuptonte faktorin e brendshëm si parësor në realizimin e luftës çlirimtare, i krijonte kushtet për një unitet politik dhe rrugë të qartë.

Por, ja që u ndoq model tjetër, me koncepte tjera, koncepti ku agjendat i vendosin të tjerët dhe ky koncept u vendos nga të tjerët.

Kemi dëgjuar edhe nga dokumentarë, e edhe nga intervistat e shumë personave në lidhje me kontaktet me shërbimet e huaja dhe ku unë nuk dua të hyj në detaje se a janë ato franceze apo të tjera, por vetëm thjesht do të donim të dinim cili është roli i tyre në përcaktimin e agjendës së luftës sonë. Le të flasë Hashim Thaçi vetë për këtë. Nëse ishte kontakt informativ, çka informonte konkretisht?

Dua të jua kujtoj pranverën e vitit 1997, kur në këtë kohë pritej që nga diaspora të vinte një grup i armatosur nga Gjermania dhe Zvicra. Adem Jashari dhe forcat burimore të kryengritjes në Kosovë e prisnin me padurim dhe kishin shprehur qartë bindjen për forcimin e luftës dhe zgjerimin e saj nga ardhja e këtij grupi. Në të njëjtën kohë, në Kosovë vijnë porositë nga Hashim Thaçi, i cili shprehte qartë “rrezikun” nga një grup që do të vinte dhe nuk do t'i sillte të mirë Kosovës.

Ky grup i armatosur nuk arriti të futej pasi ra në pritë dhe unë këtu nuk dua të them që konkretisht dikush ka informuar, apo ka spiunuar, por dua ta di...

KRYTARI: Libur! Në rend dite, për marrëveshjen!

LIBURN ALIU: ...në ato kontaktet që kanë qenë atje, a është folur konkretisht për këtë grup që ka për të hyrë.

Dua të ju përkujtoj se krahas propagandës së shumë gjatë qëndrimeve të kohëpaskohshme në Kosovë, me ç'rast Hashim Thaçi më shumë fshihej nga Adem Jashari sesa nga pushtuesi asokohe, ndër të tjera, nuk hezitonte që në propagandë të linte dyshime për qëndrimin e Adem Jasharit në Prekaz dhe lidhjet e tij me Serbinë, e që aludimet të tilla asokohe ishin bërë të përditshme.

E tërë lufta përbrenda saj e ka pasur një konflikt konceptesh dhe shumë nga këta që e përfaqësonin këtë të frontit sot janë dëshmorë. Së paku, personalisht i di disa.

KRYETARI: Liburn, deputet, kthehu në rend dite!

LIBURN ALIU: Detajet i dini edhe vetë dhe unë vetëm po jua përkujtoj dhe besoj që do të shtjellohen shpejt e në hollësi për publikun.

Ajo më e ndjeshmja e tërë luftën tonë është çështja e dëshmorit Behajdin Hallaqi. Të gjithë e dini shumë mirë për çka po flas, e konkretisht e më së miri e di Hashim Thaçi.

Behajdin Hallaqi ka qenë njëri nga tre udhëheqësit e Lëvizjes në fund të viteve të '80-ta, bashkë me Fadil Vatën dhe Afrim Zhitinë, dhe kemi pasur rastin ta shohim një dokumentar, ku Hashim Thaçi flet për këtë dëshmor.

KRYETARI: Deputet! Regjia, ia ndalni fjalën. Nuk je në rend dite.

(Ndërprerje nga regjia, diskutim pa mikrofon.)

KRYETARI: I kam dy fjalë edhe unë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Këtij vendi i duhet demokracia dhe jo autoritarizmi dhe dhuna, se nga këto veprime jodemokratike është lodhur ky vend dhe janë lodhur këta qytetarë. E kuptoj të drejtën për të protestuar, por e vlerësoj dhunë çdo veprim të jashtëligjshëm, që e pengon të drejtën e mendimit të lirë të secilit deputet në Kuvendin e Kosovës. Është dhunë pengimi i deputetëve për ta ushtruar obligimin e tyre ashtu siç është dhunë çdo sulm fizik dhe përpjekje për ta penguar institucionin ligjvënës dhe përfaqësues të qytetarëve të Kosovës. Kjo nuk është demokraci, kjo është përpjekje për të vendosur rend jodemokratik dhe nuk i duhet as këtij institucioni kjo formë e punës dhe e përpjekjeve.

Nivelin e demokracisë dhe besimin për ta ndërtuar demokracinë e kanë qytetarët e Kosovës, e kanë votuesit që na kanë sjellë këtu. Unë kërkoj që deputetët e “Vetëvendosjes” njëherë mirë të shkëputen nga veprimet jodemokratike dhe joparlamentare. Veprimet e sotme për t’i penguar deputetët dhe për t’i sulmuar ata, nuk janë demokraci dhe nuk është veprim që jep shpresë që në këtë vend do të qëndrojë demokracia edhe po të ishin ata në pushtet. Me këto forma, edhe po të vijnë në pushtet, pushon demokracia. As ky institucion, as ky vend nuk meriton të vazhdohet me këtë anarki dhe me këtë papërgjegjësi. Duhet ta dini, e keni të drejtën e fjalës, jeni 12 deputetë. Të gjithë e keni marrë fjalën rend, njëri pas tjetrit. Askush nuk jua ka penguar fjalën. Kaq është mundësia juaj demokratike. Mundësi tjera nuk keni.

Vullneti i qytetarëve, i deputetëve që janë këtu, dhe përgjegjësia e tyre është: duan ta votojnë apo nuk duan ta votojnë marrëveshjen. Unë mund ta kem mendimin e kundërt për këtë marrëveshje, dhe e kam, dhe e kam shfaqur. Jo pse jam kundër normalizimit të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, por jam kundër se kjo marrëveshje nuk garanton normalizim. Por, pse jam kundër nuk e kam të drejtën ta pengoj vullnetin e asnjë deputeti në Kuvendin e Kosovës. Kjo duhet të vlente edhe për ju. Prandaj, kërkoj që të uleni dhe të lejoni zhvillimin normal të seancës.

Fjalën e ka Florin Krasniqi, por duke iu përmbajtur rendit të ditës.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje,

Nuk dua të dal, kryetar, nga rendi i ditës, por vetëm dua ta marr një shembull historik për të gjithë ne. Edhe për mua, edhe për të gjithë. 102 vjet më parë, shqiptarët e kanë çliruar Shkupin, por janë përçarë, e sot e dini çfarë ka ndodhur. Të gjithë ata që kanë luftuar dhe kontribuar shumë, e kanë vrarë njëri-tjetrin, janë hakmarrë kundër njëri-tjetrit. Kjo pa na përcjellë 100 e sa vjet. Ne nuk jemi këtu kundër njëri-tjetrit, jemi bashkë. Bashkë për një të ardhme më të mirë, e mund nganjëherë të mos pajtohemi dhe më besoni se format e sotme të “Vetëvendosjes” janë demokratike, të demokracisë.

E tjerat kanë pasur probleme edhe më të mëdha, e sidomos andej nga vijnë miqtë tanë. Edhe demokracitë e tyre kanë pasur këso problemesh, por ne nuk jemi kundër njëri-tjetrit. Ndoshta unë, e subjekti të cilit i takoj, nuk jemi të mirë me kompromis, e kompromisi është pjesë e jetës, por besoni ky kompromis është shumë i rëndë, shumë i rëndë dhe i panevojshëm. Në qoftë se kemi nevojë për kompromis, ta bëjmë një kompromis më të mirë, por jo këtë se nuk është i nevojshëm. Mos, se nuk ka nevojë! Nëse ka nevojë, e bëjmë.

Ka pasur nevojë, është bërë edhe luftë. Janë bërë sakrifica shumë më të mëdha, andaj as unë, as subjekti im, askush këtu, nuk e ka të drejtën ta marrë pronësinë e patriotizmit. Për patriotizmin e dimë që dëshmorët janë ata që na e kanë trasuar rrugën e lirisë, por mos ta banalizojmë. Ju lutem, bashkë mund ta bëjmë një kompromis më të mirë. Mos e votoni këtë marrëveshje! Besomëni, tjetra do të jetë më e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm janë 101 deputetë. Vazhdojmë me procedurën e votimit. E votojmë amendamentin 1.

(Ndërhyrje, A. Kurti: Nuk ka votim! Kryetar, nuk bën të votohet marrëveshja!)

(Reagime, zëra, zhurmë, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: 10 minuta pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pa pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë seancën. Diskutimet kanë përfunduar. I votojmë amendamentet. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Amendamenti 1

Me 86 vota për, 3 kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti i parë.

Amendamenti 2

Me 85 vota për, 4 kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti i dytë.

Amendamenti 3

Me 82 vota për, 3 kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti i tretë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim për ta votuar projektligjin në tërësi.
Votojmë tash!

Me 84 vota për, 3 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Shkojmë në pauzë deri në orën 15:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pa pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë seancën me pikën e pestë të rendit të ditës. Ne i diskutojmë raportet, votimin e lëmë për më vonë.

5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës të Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës të Sigurisë së Kosovës e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës të Sigurisë së Kosovës, deputeti Rexhep Selimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime, nuk është këtu. Atëherë shkojmë në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e kërkon fjalën?

XHAVIT HALITI: E mbështetim.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Anton quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në ueb-sajtin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës është një prezantim i tillë ku thuhet se Ligji për Inspektoratin e Policisë e mundëson agjencia që kombinon dy funksione primare në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës, të njohura si shtyllat e politikë demokratike, siç janë: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave

penale të kryera nga punonjësit e Policisë pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor, si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë, të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Nën dy, inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi.

Ushtrimi me sukses i këtyre autorizimeve do t'i bindë të gjitha komunitetet në Kosovë që Policia e Kosovës mund dhe do të jetë e përgjegjshme, qoftë kolektivisht apo individualisht, duke punuar në ofrimin e shërbimeve dhe përkrahjen e një shoqërie të sigurt dhe stabile.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë kemi dëshirë që ky qëndrim të jetë i saktë, por unë si anëtar i Komisionit për Siguri nuk e kam të krijuar këtë bindje, sepse të gjeturat në punën e Inspektoratit të Policisë ngrenë shumë dilema rreth performansës së tyre, profesionalizmit, pavarësisë dhe paanshmërisë, modelit shembull të përfaqësimit.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për IPK-në, në takimet e përbashkëta me autoritetet e IPK-së, në debate publike, nga takimet individuale me zyrtarët e IPK-së, me zyrtarët e larguar të Inspektoratit të Policisë, zyrtarët e Policisë të trajtuar nga Inspektorati, vij në konkludim se niveli udhëheqës nuk e ka nivelin e duhur të edukatës, arsimimit dhe kulturës. Mungesën e profesionalizmit e kompensojmë me lojalitetin ndaj partisë në pushtet. Janë të prirë në krijimin e grupacioneve për të shantazhuar, disiplinuar, përjashtuar “të papërshtatshmit”. Shfaqin mosguximin për hetimin e policëve të paprekshëm. Në formën e spektakleve mediale, denigrojnë zyrtarët e Policisë, duke i akuzuar e arrestuar pa asnjë fakt të qëndrueshëm, përdorin forma manipulative për ndëshkimin apo stimulimin e punonjësve të IPK-së.

Format e tilla të punës të zyrtarët e Policisë së Kosovës krijojnë pasiguri në punët dhe obligimet e tyre të përditshme. Ata detyrohen që para çdo veprimi të kalkulojnë se mos do të ndëshkohen nëse e trajtojnë ndonjë rast të nxehtë që prek interesat e ndonjë grupacioni politik, afarist apo kriminal. Policët detyrohen që t'i mbyllin sytë ndaj dukurive që çdo ditë e më shumë po i sulmojnë vlerat morale, tradicionale, demokratike, institucionale e tjera.

I lus deputetët që t'i votojnë rekomandimet si kompromis i të gjithë anëtarëve të Komisionit, me shpresë që ato do të zbatohen në interes të Inspektoratit të Policisë të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, kërkoj nga kryeministri, ministri i Punëve të Brendshme që ta vlerësojnë kryeshefin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës sesa është në gjendje etike dhe profesionale ta përmirësojë imazhin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës, duke i zbatuar rekomandimet.

Do të ishte e pakuptimtë që këto rekomandime të zbatohen po nga ata që janë përgjegjës për gjendjen e krijuar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re i ka shqyrtuar rekomandimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe e falënderojmë Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë për rekomandimet, të cilat i ka nxjerrë gjatë monitorimit të ligjit. Njëkohësisht, i përkrahim rekomandimet e Komisionit Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Rekomandimet e ofruara për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë rekomandime, të cilat janë nxjerrë në Komisionin Parlamentar për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcave të Sigurisë së Kosovës, ku grupi punues, i cili ka punuar shumë afër me agjencinë, po ashtu duke pasur takime të veçanta edhe me përfaqësues të agjencisë, duke e mbikëqyrur këtë agjenci, konsideroj se janë të gjetura, të cilat duhet të eliminohen me mangësitë dhe me dëmtimin që i është bërë këtij institucioni, që u tha edhe nga zoti Quni.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah rekomandimet dhe kërkon nga ministri dhe kryeministri që ta vlerësojnë në bazë të rekomandimeve punën e kryetarit të kësaj agjencie. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

I poslanička grupa “Zajednička Budućnost” preporučuje usvajanje svih preporuka koje je dala radna grupa i Komisija za bezbednost, i da i ministru Unutrašnjih Poslova preporučuje da se pozabavi Agencijom zbog nepravilnosti, koje smo pronašli u radu te agencije. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje!

Përshëndetje për deputetët!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin në fjalë. Faktikisht, edhe gjatë punës së grupit punues të komisionit ka marrë pjesë në grupin punues dhe është e vërtetë që gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor janë identifikuar disa lëshime, të meta dhe çalime në drejtim të zbatimit të Ligjit të Inspektoratit Policor.

Fillimisht, mund të them që është për të kuptuar këtë çalim, për arsye se me ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin Policor, ky inspektorat ka marrë ingerenca dhe kompetenca të dala nga Ligji për hetuesinë e rasteve të zyrtarëve policorë, të cilët eventualisht mund të jenë të inkriminuar nëpër krime të ndryshme dhe nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të bëjë edukimin e kuadrove dhe trajnimin e tyre për t'u marrë me rastet në fjalë.

Është e vërtetë që pjesa inspektuese dhe Drejtoria Inspektuese e Inspektoratit Policor është një prej segmenteve, të cilat kanë shumë rezultate pozitive dhe ka bërë propozime, hulumtime dhe vlerësime të Policisë së Kosovës, mirëpo menaxhmenti çalon në drejtim të administrimit të hetimeve dhe në drejtim të menaxhimit të kuadrit të vet, si dhe në drejtim të menaxhimit të financave.

Grupi Parlamentar i partisë sonë e pranon këtë raport dhe propozon që të votohet në parim. Gjithashtu, është edhe për rekomandimet të cilat i drejtohen ministrisë dhe inspektoratit në drejtim të përmirësimit të cilësisë së punës të stafit menaxhues të inspektoratit, por edhe vetë inspektoratit, për të qenë ky inspektorat një mekanizëm i mirë, efikas në drejtim të parandalimit të krimeve të zyrtarëve policorë dhe të tjerë, që bashkëpunojnë me zyrtarë policorë, të cilët eventualisht janë të involvuar në vepra joligjore.

Përpos mbikëqyrjes nga komisioni ynë dhe grupit punues të komisionit tonë, vlen të ceket se është një mangësi te inspektorati, që nuk e ka një sistem ligjor të kontrollit të vetë inspektoratit, për t'u evidentuar të metat, lëshimet dhe dobësitë, të cilat inspektorati i zhvillon gjatë aktiviteteve të veta eventuale. Mendoj që do të ishte një mekanizëm fillestar mbrojtës për t'u evituar të metat, qoftë ato administrative, qoftë të tjera.

Me zbatimin e rekomandimeve, të cilat janë me kujdes të përpiluara dhe të hartuara nga grupi punues, besoj që do të ndikojnë që Ligji për inspektoratin të zbatohet në plotësi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë mendova që kjo pikë e rendit të ditës, e cila është e rëndësishë së veçantë, do të shtyhet dhe po i jap arsyet pse. Sepse, kemi të bëjmë me një raport të nxjerrë nga Komisioni Funkcional. Një raport, i cili, për mendimin tim, shpreh mendimin pozitiv dhe e vlerësoj për mënyrën e punës, tamam ashtu siç i takon edhe me Rregulloren të Kuvendit, por edhe ushtrimit të funksionit të mandatit të deputetit nën mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve.

Ne kemi të bëjmë me një institucion, i cili është i rëndësishë së veçantë dhe që ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve të vendit tonë dhe me kontrollin ligjor që i bëhet, apo me shkeljet eventuale nga Policia e Republikës së Kosovës.

Fatkeqësisht, edhe ky trajtim me këtë joseriozitet, edhe nga Qeveria, edhe vetë mungesa këtu e ministrit të Punëve të Brendshme, tregon që dyshimet e ngrehura nga deputetët dhe

Komisioni Funkcional e tregojnë të vërtetën, sepse ky institucion ka tendenca që të politizohet dhe të mos kryejë apo të mos e ushtrojë funksionin e vet sipas ligjit dhe Kushtetutës.

Këtë po e them edhe nga vetë shembujt apo të gjeturat që i ka dhënë raporti në fjalë, sidomos me aferat e mëdha që kanë të bëjnë me Policinë e Republikës së Kosovës dhe dyshimet që aty janë futur, edhe krimi, edhe korrupsioni.

Ruajtja e njerëzve, të cilët janë profesionalisht të ngritur dhe të cilët janë të trajnuar me vite të tëra, edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë të respektuar, por edhe nga vetë institucionet e vendit, shihet qartë që këtu është anashkaluar, fatkeqësisht shumica prej tyre janë zëvendësuar, me të drejtë apo pa të drejtë, unë nuk mund ta vlerësoj, por nga raporti në fjalë shprehen dyshime të tilla. Kjo tregon që ka ndërhyrje të mëdha në institucionet e pavarura. E unë shumë kam besuar që së paku ky institucion do të lihet i qetë për ta bërë punën e vet.

Një ndër aferat më të mëdha që ka ndodhur vitin e kaluar, vjedhja në Dhomën e Dëshmive në Pejë, e cila është kamufluar me vjedhjen e arit dhe që është paraqitur edhe këtu në raport, e sidomos me njerëzit që kanë qenë të arrestuar dhe dalja në mënyrë publike nga Inspektorati Policor i Kosovës, tregon qartë se këtu prapa kësaj fshihen edhe disa afera edhe shumë më të mëdha. Dhe, lidhja e krimit të organizuar me segmente të caktuara me Policinë e Kosovës, si dhe mbulesa që i bëhet nëpërmjet këtij inspektorati, duhet të jetë shqetësuese për deputetët, e jo vetëm për komisionin, por edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Qeverinë, në përgjithësi.

Ne kemi shkelje çdo ditë dhe këto nuk duhet të fshihen, ashtu siç kemi suksese çdo ditë nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, por edhe kemi shkelje të të drejtave të njeriut dhe shkelje të të drejtave elementare të qytetarëve, sidomos me ato që përballen në rrugë dhe në hetimin e krimit dhe të korrupsionit.

Prandaj, unë e ndava këtë shqetësim, por njëherësh kërkoj që ky raport të trajtohet në mënyrë më serioze, sepse edhe vetë ashtu e thashë vlerësimin që është hartuar në mënyrë shumë serioze dhe besoj që duhet të jetë shembull i marrjes së përgjegjësisë, i hartimit dhe i zbatimit të këtyre rekomandimeve, që i ka dhënë komisioni në fjalë.

Unë edhe një herë po e them me përgjegjësinë më të madhe, duhet të jemi të brengosur për politizimin e institucioneve të pavarura, e sidomos atyre që kanë të bëjnë me segmentin e drejtësisë, sundimin e rendit apo sundimin e ligjit në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar tjerët për diskutim. Për votim s'kemi kuorum, prandaj vazhdojmë me raportin tjetër:

6. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2012

Raportin vjetor të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni për Legjislacion dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar ta miratojë.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ka konkluduar se raporti ka mangësi dhe si i tillë nuk duhet të procedohet.

Është një problem që po ashtu vazhdon të përcillet në këtë Kuvend, domethënë për raportet të cilat nuk aprovohen në Kuvend, cilat janë pasojat që ndodhin prej institucionin të cilit nuk i kalon raporti?

Nuk ka një standard të unifikuar se çka do të bëhet, mirëpo si konkluzion, komisioni ka rekomanduar që ky raport të mos kalojë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Safete, nuk është këtu. Në emër të Grupit, fjalën e ka kërkuar deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi analizuar dhe e kemi diskutuar raportin e punës dhe me pakëz vërejtje e kemi arritur një pajtim, i e cili përmbledhurazi është ky:

Gjithë punën që e kanë, ajo bërë çmohet. 30 000 emra që janë hequr nga lista e votuesve, është punë e çmuar e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe punët tjera vlerësohen, të mos i përshkruaj një nga një, siç janë, se mund t'i lexoj këtu dhe mund të bëhem një ciceron dhe asgjë tjetër. Por, përmbledhtazi, do të them se në Grupin Parlamentar jemi pajtuar që të mbështetet dhe t'i jepet një 'po' këtij raporti, sepse konsiderojmë se është bërë punë mjaft komplete dhe një raport i përmbledhur në të shumtën e çështjeve, të cilat do të duhej t'i trajtonim në një raport të caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes të veçantë këtë raport, pasi kemi të bëjmë me një institucion si kategori kushtetuese, por edhe një institucion, i cili është përfolur sidomos viteve të fundit, e që ka të bëjë jo vetëm me lëndimet që kanë ndodhur nga zgjedhjet e fundit të vitit 2010, por edhe ato në 2011-2012, dhe tash pretendimet tona për zgjedhjet e ardhshme, për të cilat konkludojnë e dalin edhe shqetësime tona po nga ky raport.

Unë do ta arsyetoj mendimin tonë se pse ne mendojmë që raporti nuk është konkret dhe nuk është në formën e dëshiruar, që t'i paraqesë vështirësitë apo edhe sfidat të cilat kanë qenë në Komisionin Qendror Zgjedhor, jo vetëm te menaxhimi i procesit zgjedhor të vitit

2012, por edhe menaxhimi dhe ambiciet e këtij komisioni për vitet e ardhshme dhe sidomos për vitin 2013.

Arsyeja kryesore që nuk duhet të anashkalohet dhe të përmendet vetëm shkarazi është pastrimi i listave zgjedhore, që është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e që duhet të bëhet në koordinim me Komisionin Qendror Zgjedhor dhe ky është shqetësimi ynë primar.

Këtë e themi, sepse dalja në zgjedhje në disa komuna, të cilat kanë rezultuar me vjedhje të votave, tregon qartë se këtu akoma vazhdon një neglizhencë e theksuar edhe nga vetë ky komision dhe kjo është ajo pse ne mendojmë që ky raport nuk është i kompletuar.

E dyta, ka të bëjë me çështjet e menaxhimit të procesit zgjedhor. Ne kemi pasur zgjedhje edhe në vitin 2012 - zgjedhje lokale për shkak të shkarkimit të dy kryetarëve të komunave, Kaçanik dhe Ferizaj, dhe është parë e njëjta situatë, e ndoshta e minimizuar e keqpërdorimit të votës së qytetarit dhe vullnetit të qytetarëve - votimi familjar, pastrimi jo i listave, problemet në qendra të votimeve dhe këtu asnjë nuk është paraqitur në raportin në fjalë.

Arsyet që atakohen ndoshta subjektet politike, se është përgjegjësi e tyre mbarëvajtja e procesit zgjedhor, unë nuk mendoj se qëndron dhe mbi bazën e kësaj arsyeje edhe vota jonë ka qenë kundër këtij raporti edhe në Komisionin FunkSIONAL.

Dhe, derisa nuk paraqitet e tëra se si është menaxhuar nga një vit, jo vetëm ajo financiare, që mund të jetë e saktë dhe në mënyrë shumë të rregullt, por çështja e menaxhimit të zgjedhjeve, pretendimi për zgjedhje të lira dhe të organizuara mirë nga Komisioni Qendror Zgjedhor, ne nuk mund ta votojmë një raport të tillë.

KRYETARI: Nga Aleanca, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Ne mendojmë se raporti është më shumë përshkruar dhe jo i detajuar ashtu si duhet, prandaj është lënë e drejta e deputetëve të votojnë për ose kundër.

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja! Nuk është. Të tjerë nuk ka të lajmëruar dhe po vazhdojmë.

7. Njoftim për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

1. Grupi Parlamentar SLS ka propozuar ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare si në vijim:

- Deputeti Hamza Balje propozohet anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Petar Miletqi;

- Deputeti Sreten Ivanović propozohet anëtar i Komisionit për Legjislacion, në vend të deputetes Jasmina Zhivković.

2. Grupi Parlamentar “Zajednička Budućnost” ka propozuar ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, si në vijim:

- Deputetja Vesna Mikić propozohet anëtare e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Goran Marinković.

- Deputeti Etem Arifi propozohet anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetes Biserka Kostić.

- Deputeti Vesimir Savić propozohet zëvendëskryetar i dytë i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në vend të deputetit Boban Todorović.

Pasi nuk kemi kuorum për të votuar dhe nuk kemi pika tjera të rendit të ditës, këto mbeten të votohen në seancën e radhës, prandaj këtu e mbylлим këtë seancë.

Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 qershor
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete,
Zotërinj deputetë,
I nderuar zoti kryeministër,
Zotërinj zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me pikat e mbetura nga punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 27 qershor 2013.

- Votimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Në sallë janë 67 deputetë, kështu që kushtet për punë janë të plotësuara. Fillojmë me votimin e mbetur për raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e raportit. Tani në sallë janë 67 deputetë. Votojmë tash!

Konstatoj se me 58 vota për, 1 kundër, 4 abstenime, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

- Votimi i raportit të punës së Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2012

Vazhdojmë me votimin e raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

Tani në mbledhje janë 76 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 55 vota për, 9 kundër, 4 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

- Votimi i propozimit të Grupit Parlamentar SLS dhe Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Pika e tretë që duhet ta votojmë është votimi i njoftimit të propozimit të Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi propozimet e Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

Konstatoj që seanca e mbetur me kaq përfundoi. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*